

KËRKESË – PADI

- PADITËS:** **Besnik Muçi**, i biri i Meleq-it, i datëlindjes 18.01.1973, lindur në Pogradec dhe banues në Tiranë, Rruga “Faik Konica”, identifikuar me ID nr. Personal H30118041B, dhe adresë komunikimi: Rr. “Presidenti G. W. Bush” Pallati 1 (Kasmi) kati 3, nr. 15, Tiranë, cel 0692061173, email: besnik_muci@yahoo.com.
- I PADITUR:** **Kuvendi i Republikës së Shqipërisë**, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 4, Tiranë.
- PERSON I TRETË** **Avokati i Popullit**, me adresë: Rruga “Vëllezërit Huta”, Tiranë.
Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, me adresë: Rruga e Kavajës, “Godina e ish-Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve”, Tiranë.
Presidenti i Republikës, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, 1000, Tiranë
- OBJEKTI:**
1. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit Nr. 82/2017 të Kuvendit “Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në Institucionet e Rivlerësimit sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
 2. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit të Kuvendit Nr. 14 datë 06.03.2017 “Për kthimin e dosjeve të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit tek Avokati i Popullit për riplotësim të dokumentave dhe rihapjen e thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit nga aplikantë të rinj për pozicionet e të gjithë anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit”.
 3. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit Nr. 18 datë 16.03.2017 “Për kthimin e dosjeve të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit tek Avokati i Popullit për riplotësim të dokumentacionit”
 4. Detyrimin e organit publik Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të procedojë me konstatimin e pavlefshmërisë dhe anulimin e vendimit të Kuvendit të Shqipërisë Nr. 82/2017 “Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në Institucionet e Rivlerësimit sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në përgjigje të kërkesës së drejtuar atij nga paditësi Besnik Muçi, më datë 30.09.2020 për të cilën Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka heshtur
- BAZA LIGJORE:** Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 179/b, B(1), B(2), B(3) gërma “a” e Aneksit, neni C pikat 5-12 e Aneksit;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 6, 7, 8, 9, 10, 11; Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë nenet 2(1), 3(6) dhe (7) pika “b”, 107, 108. a.i dhe ii , 108.b, 109/d, 110, 114, 117.

Ligji Nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” , i ndryshuar nenet 7/a dhe b, 10/1, 15/a, 17/1/c dhe ç, 18/1.d dhe 18.8.

**DREJTUAR: GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË
TIRANË, Rruga “Rruga “Don Bosko”, Tiranë**

I nderuar Z/znj Kryetare!

Rrethanat e faktit:

1. Unë paditësi, për shkak të ish funksionit tim si ish Prokuror, i jam nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Komisioni i Pavaruar i Kualifikimit¹ me vendimin nr. 58 datë 01.08.2018 vendosi konfirmimin tim në detyrë. Mbi bazën e ankimit të Komisionerit² Publik Darjel Sina Kolegji i Posaçëm i Apelit³ me vendimin nr. 32 datë 21.11.2019 vendosi ndryshimin e vendimit nr. 58 datë 01.08.2018 dhe shkarkimin tim nga detyra, pavarësisht se në kohën e shkarkimit unë isha emëruar Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.
2. Kuvendi i Shqipërisë me Vendimin Nr. 82/2017 “Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në Institucionet e Rivlerësimit, sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në mbështetje të nenit C, pika 12 të Aneksit të Kushtetutës, të neneve 10, pika 10, dhe 11, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 17, pikat 2 dhe 8, të vendimit të Kuvendit nr. 40/2017 “Për procedurat parlamentare për funksionimin e komisioneve ad hoc dhe realizimin e procesit të votimit, sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në listën përfundimtare të komisionerëve, gjyqtarëve dhe komisionerëve publikë të zgjedhur, të hartuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, sipas raporteve të komisioneve ad hoc të përzgjedhjes, vendosi të miratohet lista në bllok e kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
3. Pas shkarkimit tim nga detyra si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese jam vënë në dijeni të faktit që pesë antarët e trupës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit që gjykuan çështjen time dhe Komisioneri Publik Darjel Sina janë emëruar në këto funksione nga Kuvendi i Republikës, me Vendimin nr. 82 datë 17.06.2017, në shkelje të Kushtetutës dhe Ligjit, në kundërshtim me procedurën e parashikuar në Kushtetutë dhe Ligj, është nxjerrë bazuar në akte është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit të kandidatëve, paraqitjes së

¹ KPK më poshtë në këtë dokument.

² KP më poshtë në këtë dokument.

³ KPA më poshtë në këtë dokument.

dokumente të falsifikuara si dhe për shkak se kandidatët nuk kanë plotësuar kriteret e parashikuara në Kushtetutë dhe në Ligj.

4. Pasi jam vënë në dijeni të këtyre fakteve dhe kam mbledhur të dhëna dhe prova që konfirmojnë ato, më datë 30.09.2020 i jam drejtuar me kërkesë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Presidentit, Avokatit të Popullit si dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit^{4,5}, i cili ushtron veprimtarinë e tij administrative në territorin dhe juridiksionin e Republikës së Shqipërisë, **që të anulojnë si të paligjshëm Vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Nr. 82/2017** “Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në Institucionet e Rivlerësimit, sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” lidhur me zgjedhjen si anetarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit të aplikantëve Ardian Hajdari, Rezarta Schuetz, Natasha Mulaj, Albana Shtylla dhe Sokol Çomo si dhe Dariel Sina Komisioner Publik, pasi që në momentin e zgjedhjes këta individë nuk kanë përmbushur kriteret kushtetuese dhe ligjore për t’u zgjedhur në këto funksione, por nuk kam marrë një përgjigje pozitive.

Në lidhje me kompetencën funksionale dhe lëndore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë për shqyrtimin e çështjes .

5. Në nenin 7.a të ligjit 49/2012 përcaktohet se Gjykatat administrative janë kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik, ndërsa në nenin 8 të tij përcaktohet se gjykata administrative nuk shqyrton mosmarrëveshjet, të cilat lidhen me aktet nënligjore normative që, sipas Kushtetutës, janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese; apo aktet shqyrtimi i të cilave, sipas legjislacionit në fuqi është në kompetencën e një gjykate tjetër.
6. Vendimit Nr. 82 i vitit 2017 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë është një akt administrativ individual në kuptim të nenit 2. 2 të ligjit Nr. 49/2012, në të cilin përcaktohet se: “2. “Akt administrativ individual” është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete”. Në nxjerrjen e tij, Kuvendi ka ushtruar veprimtari administrative dhe jo ligjvënëse. Kjo kompetencë i është njohur Kuvendit me nenin C.12 të Aneksit të Kushtetutës.
7. Në vendimin Nr. 36/2015 Gjykata Kushtetuese është shprehur se: “32. Gjykata çmon se neni 131/c i Kushtetutës parashikon se Gjykata Kushtetuese vendos për pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Në kuptim të kësaj dispozite, Gjykata thekson se karakteri normativ i aktit të kundërshtuar është elementi përcaktues që ndan juridiksionin kushtetues nga ai i gjykatave të zakonshme. Vetëm aktet normative mund

⁴ ONM më poshtë në këtë dokument.

⁵ Mision përbashkët i BE dhe SHBA i cili sipas një marrëveshjeje me Qeverinë Shqiptare do të monitorojë dhe kontrollojë procesin e rivlerësimit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
<https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/imoofficial26.01.2017.pdf>
https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/imoofficial26.01.2017_annexe.pdf

të jenë objekt i kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës që ushtron kjo Gjykatë, ndërkohë që aktet individuale i nënshtrohen kontrollit të sistemit të zakonshëm gjyqësor. 33. Duke analizuar vendimin nr.79 të datës 23.10.2014 të Kuvendit të Shqipërisë “Për shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së së zgjedhur nga Kuvendi, zotit Elvis Çefa” dhe vendimin nr.80 të datës 23.10.2014 të Kuvendit të Shqipërisë “Për shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së së zgjedhur nga Kuvendi, zotit Lulzim Lelçaj”, Gjykata çmon se strictu sensu këto vendime u drejtohen palëve (dy anëtarëve të KLD-së) si subjekte individualisht të përcaktuara. Gjithashtu, objekti i vendimit është konkret. Efekti i këtyre vendimeve është shkarkimi i anëtarëve të KLD-së, duke u dhënë këtyre vendimeve përmbajtjen e akteve me karakter individual.

8. Nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.59/2014 shprehet se: “Lidhur me shtrirjen e juridiksionit të saj në kontrollin e akteve normative/individuale të organeve qendrore, Gjykata ka theksuar se vetëm aktet normative mund të jenë objekt i kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës, që ushtron kjo Gjykatë, ndërkohë që aktet individuale i nënshtrohen kontrollit të sistemit të zakonshëm gjyqësor. Në një rast Gjykata ka çmuar se vendimi i kundërshtuar nuk përmban tipare të një akti me karakter normativ, pasi nuk vendos norma të përgjithshme sjelljeje, me karakter abstrakt, që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike, të cilat i shtrijnë efektet e tyre mbi një kategori të pacaktuar subjektësh (Vendim i Mbledhjes së Gjyqtarëve nr.35/2013). Karakteri normativ i aktit të kundërshtuar është elementi përcaktues që ndan juridiksionin kushtetues nga ai i gjykatave të zakonshme. Gjykata ka theksuar se një akt me karakter normativ duhet të vendosë norma të përgjithshme sjelljeje, me karakter abstrakt, që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike, të cilat i shtrijnë efektet e tyre mbi një kategori të pacaktuar subjektësh. Një akt individual i referohet një fakti konkret, jo një numri faktesh të mundshme ose hipotetike, dhe i jep zgjidhje një çështjeje konkrete, me natyrë teknike dhe jo normative. Akti individual është vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete, ndërsa akti normativ, është vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk është shterrues në zbatimin e tij, kuptim i dhënë edhe nga ligji nr. 49, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Në vlerësimin e Gjykatës, tri kritere përcaktojnë ndarjen e aktit nënligjor në individual ose normativ: (i) Subjektet të cilave akti u drejtohet - subjekte individualisht të përcaktuara të së drejtës/një grup personash të përcaktueshëm në bazë të karakteristikave të përgjithshme ose subjekte të papërcaktuara të së drejtës; (ii) Objekti - krijimi, ndryshimi ose shuarja e një marrëdhënieje juridike konkrete e së drejtës administrative ose përcaktimi i normave të përgjithshme të sjelljes me karakter abstrakt; (iii) Karakteri shterues/jo shterues - efektet shtrihen te subjekte të përcaktuara dhe në mënyrë të njëhershme ose te subjekte të papërcaktuara të së drejtës, në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme (Shih vendimin nr.29, datë 21.10.2009 dhe vendimin nr. 14, datë 21.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese).

Në çështjen konkrete, kërkuesi kërkon shpalljen absolutisht të pavlefshme të akteve të Kuvendit të marra, sipas tij, në kundërshtim me rregulloren e Kuvendit. Aktet, të cilave

u referohet kërkuesi, janë: a) vendimi i Kuvendit nr.12/2014 “Për shpalljen si të pavlefshëm të vendimit nr.1/2013 të Kuvendit “Për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive”; b) vendimi i Kuvendit nr.13/2014 “Për mosmiratimin e propozimit të Presidentit të Republikës me dekretin nr.7928, datë 16.1.2013 “Për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive”; c) vendimi i Kuvendit nr.14/2014 “Për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive”. **Gjykata konstaton se të tri aktet janë akte individuale, që lidhen me procesin e kontrollit dhe më pas të shkarkimit të një funksionari publik, konkretisht të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI. Si konkluzion, kontrolli kushtetues i këtyre akteve nuk është në juridiksionin e kësaj Gjykate, por të gjykatave administrative, para së cilës aktualisht po zhvillohet një proces gjyqësor administrativ për kundërshtimin e këtyre akteve nga ish- Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI. “**

9. Referuar jurisprudencës së sipërpërmendur të Gjykatës Kushtetuese dhe përmbajtjes së vendimit Nr. 82 të vitit 2017 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë rezulton e qartë se ky akt i përmbush kriteret e përcaktuara në ligj për ta identifikuar atë si akt administrativ individual pasi: i) Subjektet të cilave akti u drejtohet janë subjekte individualisht të përcaktuara të së drejtës si anëtarë të institucioneve të rivlerësimit, ai ka për objekt krijimin e marrëdhënieve juridike konkrete të emërimit të disa anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit dhe akti ka karakter shterues pasi efektet shtrihen te subjekte të përcaktuara, si anëtarë të institucioneve të rivlerësimit. Ky akt përbën një akt administrativ individual, shqyrtimi i ligjshmërisë së të cilit përbën lëndë për gjykatat administrative në kuptim të neneve 7.a dhe 10.1 dhe 10.2.a të ligjit Nr. 49/2012.
10. Duke qenë se përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve të Vetëingut ka një rëndësi të veçantë për të garantuar kryerjen e procesit të rivlerësimit në respektim të rregullave që dikton procesi i rregullt ligjor, një ndër shtyllat e të cilit është çështja e “Gjykatës së krijuar me ligj dhe të paanshme”, një rëndësi të veçantë merr edhe çështja nëse vendimi Nr. 82 i vitit 2017 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë është një akt administrativ i ligjshëm, pasi vetëm ligjshmëria e tij do të garantojë zbatimin e një reforme në drejtësi të mbështetur në Kushtetutë dhe në ligj që do të përmbushë qëllimin e saj “rikthimin e besimit të publikut tek drejtësia”.
11. Kushtetuta, Aneksi C i saj, si dhe ligji nr. 84/2016 përcaktojnë një sërë procedurash në emërimin e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, si dhe një sërë kriteresh që një kandidat duhet të plotësojë për t’u përzgjedhur si anëtar i institucioneve të rivlerësimit.
Respektimi rigoroz i procedurës së përzgjedhjes dhe plotësimi i kushteve ligjore për të qenë kandidat dhe anëtar i institucioneve të rivlerësimit krijon premisën e duhur për të garantuar kryerjen e rivlerësimit kalimtar në respektim të parimeve të procesit të rregullt ligjor, element i të cilit është jo vetëm respektimi i të drejtave themelore të subjektit të rivlerësimit, por edhe respektim i parimit të “Gjykatës së krijuar me ligj” dhe “gjykatës së paanshme”, ashtu sikurse e kërkon neni 179/b.2 dhe 179/b.6 i Kushtetutës.

12. Duke e cilësuar vendimin e shkarkimit tim nga detyra nr. 32 datë 21.09.2019 si një vendim në shkelje të rregullave dhe parimeve që dikton e drejta për proces të rregullt ligjor e kam ankimuar atë në GJEDNJ. Pas shpalljes së tij, kam kërkuar informacion në lidhje me procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit që kanë gjykuar rastin tim, përmbushjen e kriterëve kushtetuese dhe ligjore prej tyre për të qenë pjesë e këtyre institucioneve të rivlerësimit dhe për të kuptuar nëse Vendimi i Kuvendit të Shqipërisë Nr. 82/2017 me të cilin është miratuar lista e kandidatëve të institucioneve të rivlerësimit ishte një vendim i ligjshëm me të cilin ishin përzgjedhur kandidatë që i plotësonin, apo jo kriteret kushtetuese dhe ligjore për të qenë të tillë.
13. Nga informacioni që më është vënë në dispozicionin rezulton se në rastin e miratimit si anëtarë të institucioneve të rivlerësimit të anëtarëve që kanë shqyrtuar rastin tim **nuk është respektuar procedura e përzgjedhjes dhe as se ata i plotësonin kriteret ligjore për të qenë të tillë.**
14. **Legjitimimi aktiv në paraqitjen e kërkesë padisë dhe plotësimi i kushteve të tjera formale.**
- 14.1. Duke qenë se Vendimi i Kuvendit nr. 82 i vitit 2017 është një akt i nxjerrë në kuadrin e veprimtarisë administrative të Kuvendit të Shqipërisë, kundërshtimi i tij mund dhe duhet të bëhet sipas rrugëve dhe mënyrave të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.
- 14.2. Si Ish-Anëtar i Gjykatës Kushtetuese, i shkarkuar nga anëtarët e institucioneve të rivlerësimit të emëruar me aktin administrativ objekt kundërshtimi, jam cenuar drejtpërdrejt nga mosrespektimi i rregullave të procesit të rregullt ligjor që kanë të bëjnë me gjykatën e krijuar sipas ligjit dhe gjykatën e paanshme dhe në kuptim të nenit 15.a të ligjit nr. 49/2012 kam interes të ligjshëm në ngritjen padisë, pasi konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ me të cilin është krijuar gjykata në kundërshtim me ligjin, përbën një garanci për rivendosjen e të drejtave të mia, duke qenë se ndaj vendimit të KPA-së kam paraqitur ankim në GJEDNJ. Në rastin eventual të pranimit të padisë, gëzoj të drejtën e rishqyrtimit të çështjes nga një gjykatë e krijuar sipas ligjit dhe e paanshme si dhe të drejtën e dëmshpërblimit për dëmin që më është shkaktuar si pasojë e mosgarantimit të një procesi të rregullt ligjor.
- 14.3. Neni 44 i Kushtetutës më garanton të drejtën e rehabilitimit dhe/ose të zhdëmtimit në përputhje me ligjin, në rast se jam dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore, ndërsa nenet 1.1 dhe 3.a i ligjit nr. 8510/1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore “më garantojnë të drejtën e dëmshpërblimit për dëmin që më është shkaktuar nga veprimet e kundërligjshme të organeve të administratës shtetërore.
- 14.4. Padia i plotëson kushtet e tjera formale, pasi kërkimet për pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nuk i nënshtrohen ndonjë afati parashkrimi. Sipas nenit 18.8 të ligjit nr. 49/2012, padia për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ mund të ngrihet në çdo kohë, nga ana tjetër, ligji nuk parashikon në këtë rast shterimin e ankimit administrativ.

15. Pretendimet se vendimi nr. 82/2017 është nxjerrë në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligj për zgjedhjen e anëtarëve të KPA-së dhe KP-së.

15.1. Ndryshimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të vitit 2016,⁶ parashikuan procesin e rivlerësimit për gjyqtarët dhe prokurorët në Shqipëri. Me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” u përcaktuan parimet, rregullat, metodologjia, procedurat, standardet si dhe ngritja, organizimi dhe funksionimi i Institucioneve të rivlerësimit përfshirë dhe Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit dhe rolin e tij.

15.2. Sipas parashikimeve Kushteuese dhe ligjore, hapi i parë i këtij procesi ishte ngritja e Institucioneve që do të kryenin rivlerësimin, si fillim e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe më pas e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Komisionerëve Publikë dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. ONM-ja ishte institucioni i parë që u krijua pasi ai së bashku me Presidentin e Republikës ose Avokatin e Popullit dhe Kuvendin, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës, neni B(1), B(3)(a) dhe neni C(5)-(12) të Aneksit të Kushtetutës si dhe neneve 6-11 të Ligjit nr. 84/2016, duhet të zgjidhnin dhe zgjedhën anëtarët e Institucioneve të tjera KPK, KPA dhe KP.

15.3. Në vijim të procedurës së zgjedhjes së anëtarëve të KPK, KP dhe KPA, duke qenë se Presidenti nuk pranoi të ushtronte detyrimet e ngarkuara nga Kushtetuta⁷, Avokati i Popullit organizoi procesin e aplikimit të kandidatëve dhe verifikimin e plotësimit të kriterëve formale. Sipas pikës 6 të nenit C të Aneksit të Kushtetutës listat me aplikantët që plotësonin kriteret formale për secilin pozicion dhe ata që nuk plotësonin iu dërguan⁸ ONM-së. Kjo e fundit kishte detyrimin të verifikonte dhe vlerësonte kandidatët sipas kriterëve dhe të bënte rekomandimet për Kuvendin.

15.4. Avokati i Popullit dhe ONM-ja i dërguan Kuvendit dy lista; njëra me kandidatë që plotësonin kriteret dhe tjetra me kandidatë që nuk plotësonin kriteret. Kuvendit ngriti një Komision me 6 pjesëtarë, deputetë, që shqyrtoi listat. Sipas nenit C(8) e Aneksit të Kushtetutës⁹ një Komision me pesë vota mund të bënte kalimin e kandidatëve nga lista e atyre që nuk i plotësojnë kriteret, sipas ONM-së, në listën e atyre që i plotësojnë apo te lista e kandidatëve për votim. Më pas Kuvendi procedoi me zgjedhjen e anëtarëve të Institucioneve të rivlerësimit.

15.5. Konstatimi i mospërbushjes së kriterëve nga Avokati i Popullit dhe ONM. Fakti që zgjedhja e disa anëtarëve të KPA-së dhe KP është kryer në mënyrë të paligjshme provohet nga komunikimet zyrtare¹⁰ të institucioneve përgjegjëse për

⁶ Neni 179/b dhe Aneksi i Kushtetutës.

⁷ Neni C(6) paragrafi i fundit e Aneksit të Kushtetutës.

⁸ Neni C(7) i Aneksit të Kushtetutës.

⁹ “Brenda tre ditëve nga marrja e listës së kandidatëve, të cilët i plotësojnë kriteret formale, listës së kandidatëve, të cilët nuk i plotësojnë kriteret formale dhe listës së rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, Kuvendi krijon një komision ad hoc me gjashtë anëtarë të ndarë në mënyrë të barabartë midis shumicës dhe pakicës parlamentare. Komisioni, me të paktën katër vota, mund të kalojë një kandidat nga lista e kandidatëve, të cilët nuk i plotësojnë kriteret formale tek lista e kandidatëve, të cilët i plotësojnë kriteret formale. Komisioni, me të paktën pesë vota, mund kalojë një kandidat nga lista e kandidatëve të rekomanduar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit tek lista e kandidatëve për votim. Brenda dhjetë ditëve nga krijimi i tij, komisioni ad hoc i përcjell listën e kandidatëve për votim për secilin pozicion komisioneve ad hoc përzgjedhëse. Dy listat e tjera nuk dërgohen për votim”.

¹⁰ Shkresa e Avokatit të Popullit nr. 8/1 datë 03.02.2020 dërguar Besnik Muçi “Kthim përgjigje kërkesë për informacion”, ku midis të tjera thuhet se “... gjeni bashkëngjitur kopje të dokumentacionit që vërteton procedurën e ndjekur nga institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit për verifikimin e

marrjen e aplikimeve, kryerjen e vlerësimeve dhe dërgimin e listave me kandidatët që plotësojnë kriteret dhe ata që nuk plotësojnë kriteret, Avokati i Popullit, Bordi Drejtues të ONM-së dhe Kuvendi i Shqipërisë¹¹.

- 15.6.** Konkretisht faktin që anëtarët e KPA Ardian Hajdari, Rezarta Schuetz dhe Natasha Mulaj nuk i kanë plotësuar kriteret e kanë konstatuar dhe Avokati i Popullit dhe Bordi i ONM-së. Në ushtrim të kompetencave kushtetuese¹² dhe ligjore¹³, pas aplikimit të këtyre personave Avokati i Popullit pasi kreu verifikimin e plotësimit të kriterëve i ka vendosur këta kandidatë tek lista e atyre që nuk kanë përmbushur kriteret formale për pozicionin që kanë aplikuar. Me shkresën nr. 32 datë 17.02.2017 drejtuar ONM-së konstatoi se nga shqyrtimi i kujdesshëm i dosjeve të aplikantëve që kanë shprehur interes për të qenë pjesë e institucioneve të rivlerësimit i plotësonin kriteret formale të parashikuara nga neni 6 i Ligjit 84/2016, 29 kandidatë dhe nuk i plotësonin kriteret 163 kandidatë. Aplikantët Ardian Hajdari, Rezarta Schuetz dhe Natasha Mulaj ndodheshin në listën e kandidatëve që nuk plotësonin kriteret dhe konkretisht nuk plotësonin kriterin e vjetërsisë.
- 15.7.** Në datën 03.03.2017 znj. Genoveva Ruiz Calavera, Kryetare e Bordit Drejtues të ONM-së, i ridërgoi Avokatit të Popullit listat e kandidatëve së bashku me vlerësimet dhe rekomandimet e vëzhguesve të ONM-së për secilin kandidat. Edhe këtu aplikantët Ardian Hajdari, Rezarta Schuetz dhe Natasha Mulaj rezultojnë në listën e kandidatëve që nuk plotësonin kriteret dhe konkretisht nuk plotësonin kriterin e vjetërsisë.
- 15.8.** Avokati i Popullit me shkresën nr. 57 datë 03.03.2017 i dërgoi listat Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ku përsëri aplikantët Ardian Hajdari, Rezarta Schuetz dhe Natasha Mulaj rezultojnë në listën e kandidatëve që nuk plotësoni kriteret dhe konkretisht nuk plotësonin kriterin e vjetërsisë. Në këtë listë ndodhej dhe aplikanti për KP Dariel Sina. Edhe aplikanti Luan Daci¹⁴ nuk i ka plotësuar kriteret dhe ndodhej në listën e kandidatëve që nuk plotëson kriteret.
- 15.9.** Pas këtij momenti Kuvendi, duke mos marrë në konsideratë vlerësimet e Avokatit të Popullit dhe ONM-së, **nxjerr Vendimin nr. 14 datë 06.03.2017** “Për kthimin e dosjeve të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit tek Avokati i Popullit për riplotësim të dokumentave dhe rihapjen e thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit nga aplikantë të rinj për pozicionet e të gjithë anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit”.
- 15.10.** Ky vendim është në kundërshtim të hapur dhe flagrant me parashikimet e nenit C(8)-(12) të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 8-11 të Ligjit nr. 84/2016, që parashikojnë të drejtat dhe detyrimet e Kuvendit në zgjedhjen e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, **të cilat nuk i japin asnjë kompetencë Kuvendit në procesin e aplikimit, verifikimit të kushteve dhe listimit të kandidatëve.** Me këtë veprim Kuvendi ka ndërhyrë drejtpërdrejt në kompetencat që Kushtetuta i njeh

kandidaturave për anëtar të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe kopje të njehsuar në formën e kërkuar nga ligji të jetëshkrimeve për anëtarët e këtyre institucioneve A. Hajdari, R. Schuetz dhe N. Mulaj”.

¹¹ Kuvendi i Shqipërisë dhe ONM nuk i kanë kthyer përgjigje kërkesave të mia bazuar në të drejtën e informimit.

¹² Neni C(6) dhe (7) e Aneksit të Kushtetutës.

¹³ Neni 7 i Ligjit nr. 84/2016.

¹⁴ Rezulton që 4 (katër) nga 7 (shtatë) anëtarët aktualë të KPA-së nuk i kanë plotësuar kriteret sipas Avokatit të Popullit dhe ONM-së.

vetëm Presidentit dhe në rast mosushtrimi nga ai, Avokatit të Popullit. Ky veprim është kryer për të kontrolluar këtë proces duke detyruar Avokatin e Popullit që të dërgojë në Kuvend lista me emra që ai dëshironte dhe që do i bindeshin politikisht.

- 15.11.** Kuvendi, përfaqësuar nga ish-Sekretarja e Përgjithshme, anëtarja aktuale e KPA-së Albana Shtylla¹⁵, me shkresën nr. 811/6 datë 10.03.2017 i dërgon për zbatim Avokatit të Popullit Vendimin e Kuvendit nr. 14 datë 06.03.2017 së bashku me dosjet e aplikantëve. Por, duke qenë se procedura e marrjes së aplikimeve, verifikimit të kriterëve dhe dërgimit të dosjeve të aplikantëve në Kuvend ishte parashikuar në detaje në Kushtetutë¹⁶ Avokati i Popullit nuk i ka pranuar këto dosje.
- 15.12.** Ndodhur në këtë situatë Kuvendi nxjerr përsëri një Vendim tjetër në kundërshtim me Kushtetutën, **Vendimin nr. 18 datë 16.03.2017** “Për kthimin e dosjeve të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit tek Avokati i Popullit për riplotësim të dokumentacionit”. Këtë vendim Kuvendi, përsëri përfaqësuar politikisht nga ish-Sekretarja e Përgjithshme, anëtarja aktuale e KPA-së Albana Shtylla, me shkresën nr. 939¹⁷ datë 17.03.2017 i dërgon për zbatim Avokatit të Popullit, i cili e protokollon në hyrje me nr. 69 datë 17.03.2017.
- 15.13.** Pasi është njohur me Vendimet e Kuvendit nr. 14 datë 06.03.2017 dhe nr. 18 datë 16.03.2017 Avokati i Popullit me shkresën nr. 67 datë 17.03.2017 informon Kryetaren e Bordit Drejtues të ONM-së znj. Genoveva Ruiz Calavera, duke i vënë në dukje se tashmë ajo është në dijeni të zhvillimeve dhe shprehet se “Në kushtet kur Kuvendi i Shqipërisë ka nxjerrë vendimin nr. 18/2017, për zbatimin e të cilit nevojitet riplotësimi i dokumentacionit nga ana e kandidatëve aplikantë, të cilët pas zhvillimit të procedurave përkatëse nga Avokati i Popullit si dhe vlerësimit dhe rekomandimeve të ONM-së, janë listuar në listën e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret formale ligjore për secilin pozicion, lind nevoja e bashkëpunimit të mëtejshëm ndërmjet nesh për mbarëvatjen e këtij procesi”.
- 15.14.** Pas këtyre vendimeve Avokati i Popullit, në kundërshtim të hapr dhe flagrant me të drejtat dhe detyrimet e tij kushtetuese dhe ligjore, me shkresën nr. 69 datë 17.03.2017 bën thirrje për plotësim dokumentacioni deri në datën 27.03.2017. Kushtetuta dhe Ligji nr. 84/2016 vendos afate prekluzive për kryerjen e veprimeve nga Avokati i Popullit dhe ONM lidhur me procedurën e aplimit dhe verifikimit të kriterëve. Në asnjë nga këto dispozita nuk parashikohet një veprim i tillë. Anëtarët aktualë të KPA **Ardian Hajdari, Rezarta Schuetz dhe Natasha Mulaj** për 10 ditë dorëzojnë dokumenta shtesë¹⁸. Avokati i Popullit së bashku me dy vëzhguesit e ONM-së Theo Jacobs dhe Peter Ainswoth në datën 28.03.2017 hartojnë dhe një protokoll të ri për rivlerësimin e kandidatëve, tashmë të vlerësuar një herë, duke u dhënë edhe një herë mundësinë atyre që pas paraqitjes të dokumentave të kalojnë në listën e atyre që plotësojnë kriteret formale.

¹⁵ Sipas nenit C (5) e Aneksit të Kushtetutës, funksioni i Sekretarit të Përgjithshëm, është një funksion i pastër politik pasi nuk përfaqëson Kryetarin në funksionet menaxhuese por në ushtrimin e funksioneve politike në raport me institucionet e tjera.

¹⁶ Neni C(6) dhe (7) e Aneksit të Kushtetutës.

¹⁷ Numri 9 është i korigjuar.

¹⁸ Nuk ka asnjë dokument që të provojë se çfarë dokumenta shtesë kanë dorëzuar.

15.15. Vetëm 3 ditë pas përfundimit të afatit, Avokati i Popullit me shkresën nr. 85 datë 30.03.2017 i përcjell ONM-së listën e kandidatëve të ripunuar sipas porosisë së Kuvendit. Tashmë lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret formale rritet nga 29 në 84 dhe e atyre që nuk i plotësojnë zbrit në 109. ONM-ja me shkresën me referencë (2017)1848654-06/04/2017 dërguar Avokatit të Popullit i ka përcjellë vlerësimet dhe rekomandimet e vëzhguesve të ONM-së lidhur me listat e aplikantëve. Pas kësaj, më në fund, Avokati i Popullit me shkresën nr. 104 datë 07.04.2017 i dërgon Kuvendit të Republikës listat me kandidatët që përmbushin kriteret dhe me ata që nuk përmbushin kriteret, vlerësimet dhe rekomandimet e vëzhguesve të ONM-së lidhur me listat e aplikantëve si dhe dosjet me dokumentat e secilit aplikant.

15.16. Tashmë pas riplotësimit të dokumentave dhe rivlerësimit¹⁹ kandidatët **Ardian Hajdari dhe Natasha Mulaj** kalojnë në listën e atyre që plotësojnë kriteret formale. Ndërsa kandidatja tjetër **Rezarta Schuetz**, edhe pas kësaj procedure në kundërshtim me kushtetutën dhe me ligjin, vazhdon të qëndrojë në listën e atyre që nuk plotësojnë kriteret formale. **Aplikanti për KP Dariel Sina** tashmë del te lista që plotëson kriteret.

15.17. Gjatë procedurës në Kuvend me një vendim të pastër politik të deputetëve, pa asnjë verifikim apo justifikim teknik juridik, kandidatja **Rezarta Schuetz** votohet e kalon nga lista e atyre që nuk plotësojnë kriteret formale direkt tek lista për votim.

16. Shkeljet procedurale dhe mungesa e kompetencës si shkak për pavlefshmërinë e akteve administrative objekt kundërshtimi.

16.1. Në nenin 109.a.ii të K.Pr.Administrative përcaktohet se: “*Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij;*”, ndërsa në nenin 40.4 të ligjit nr. 49/2012 përcaktohet se: “*4. Gjykata vendos rrëzimin e padisë dhe kur vlerëson se, pavarësisht shkeljeve procedurale të konstatuara të veprimtarisë administrative, pasojat do të ishin të njëjta.*”

16.2. Përmbajtja e këtyre dispozitave tregon se mosrespektimi i rregullave procedurale në nxjerrjen e aktit administrativ përbën shkak për pavlefshmërinë absolute të aktit në varësi të ndikimit të kësaj shkeljeje të procedurës në vendimmarrjen përfundimtare.

16.3. Në rastin konkret, Avokati i Popullit me shkresën nr. 57 datë 03.03.2017 i dërgoi listat Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ku aplikantët **Ardian Hajdari, Rezarta Schuetz dhe Natasha Mulaj** rezultojnë në listën e kandidatëve që nuk plotësonin kriteret dhe konkretisht nuk plotësonin kriterin e vjetërsisë. Në këtë listë ndodhej dhe aplikanti për **KP Dariel Sina**. Edhe aplikanti **Luan Daci**²⁰ nuk i ka plotësuar kriteret dhe ndodhej në listën e kandidatëve që nuk plotësonin kriteret.

¹⁹ Akt i pastër politik pasi tashmë emrat ishin përcaktuar dhe ju ridha mundësia që të “riplotësonin” dokumentat.

²⁰ Rezulton që 4 (katër) nga 7 (shtatë) anëtarët aktualë të KPA-së nuk i kanë plotësuar kriteret sipas Avokatit të Popullit dhe ONM-së.

Vendimi Nr. 14 datë 06.03.2017 “Për kthimin e dosjeve të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit tek Avokati i Popullit për riplotësim të dokumentave dhe rihapjen e thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit nga aplikantë të rinj për pozicionet e të gjithë anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit” dhe **Vendimin nr. 18 datë 16.03.2017** “Për kthimin e dosjeve të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit tek Avokati i Popullit për riplotësim të dokumentacionit” janë dy vendime të Kuvendit të nxjerra **në kundërshtim të hapur dhe flagrant me parashikimet e nenit C(8)-(12) të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 8-11 të Ligjit nr. 84/2016**, që parashikojnë të drejtat dhe detyrimet e Kuvendit në zgjedhjen e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit. Këto nuk i japin asnjë kompetencë Kuvendit në procesin e aplikimit, verifikimit të kushteve dhe listimit të kandidatëve. Edhe procedura e kthimit të dosjeve të kandidatëve nuk parashikohet në këto dispozita dhe është shkelje e hapur e procedurës së aplikimit dhe verifikimit të kushteve të kandidatëve.

16.4. Nëse kjo shkelje procedurale nuk do të kishte ndodhur, pra nëse **Kuvendi i Republikës së Shqipërisë nuk do të kishte nxjerrë vendimet Nr. 14 datë 06.03.2017 dhe nr. 18 datë 16.03.2017**, Avokati i Popullit, nuk do të kishte nxjerrë shkresën nr. 69 datë 17.03.2017 me të cilën bën thirrje për plotësim dokumentacioni deri në datën 27.03.2017, anëtarët aktualë të KPA **Ardian Hajdari, Rezarta Schuetz dhe Natasha Mulaj** nuk do të kishin mundësi të dorëzonin dokumenta shtesë²¹, Avokati i Popullit së bashku me dy vëzhguesit e ONM-së Theo Jacobs dhe Peter Ainsöoth nuk do të kishin motiv për të hartuar më datë 28.03.2017 një protokoll të ri për rivlerësimin e kandidatëve, tashmë të vlerësuar një herë, dhe në këtë mënyrë as nuk do t’u ishte dhënë atyre edhe një herë mundësinë atyre që pas paraqitjes të dokumentave të kalonin në listën e atyre që plotësojnë kriteret formale e për pasojë edhe emërimin si anëtarë të institucioneve të vetigut.

Për të njëjtën arsye, Avokati i Popullit me shkresën nr. 104 datë 07.04.2017 nuk do të kishte arsye t’i dërgonte Kuvendit të Republikës listat me kandidatët që përmbushin kriteret dhe me ata që nuk përmbushin kriteret, vlerësimet dhe rekomandimet e vëzhguesve të ONM-së lidhur me listat e aplikantëve si dhe dosjet me dokumentat e secilit aplikant.

Sa më sipër është evident fakti se shkelja e procedurës së përcaktuar në nenin C (8-11) të Aneksit të Kushtetutës ka pasur një rol vendimtar në marrjen e vendimit nr. 82/2017, duke paraqitur në listën e kandidatëve që i plotësonin kriteret, kandidatë, të cilët në fakt nuk i plotësonin ato.

15.5 Nga ana tjetër, është evident fakti se **Vendimet e Kuvendit Nr. 14 datë 06.03.2017** “Për kthimin e dosjeve të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit tek Avokati i Popullit për riplotësim të dokumentave dhe rihapjen e thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit nga aplikantë të rinj për pozicionet e të gjithë anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit” dhe **vendimi Nr. 18 datë 16.03.2017** “Për kthimin e dosjeve të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit tek Avokati i Popullit për riplotësim të dokumentacionit” janë akte administrative absolutisht të

²¹ Nuk ka asnjë dokument që të provojë se çfarë dokumenta shtesë kanë dorëzuar.

pavlefshme, të nxjerra në shkelje flagrante të procedurës së përcaktuar në nenin C të Aneksit të Kushtetutës dhe në mungesë të kompetencave të njohura nga kjo dispozitë dhe janë bërë shkak edhe për pavlefshmërinë e vendimit Nr. 82/2017.

Sa më sipër, Aktet administrative objekt kundërshtimi janë absolutisht të pavlefshëm dhe si të tillë duhet të konstatohet pavlefshmëria absolute e tyre.

17. Shkeljet e konstatuara në zgjedhjen e anëtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe mashtrimet e vendosura në themel të aplikimeve të kandidatëve të rivlerësimit si shkak për pavlefshmërinë e aktit vendimit Nr. 82/2017.

17.1. Në nenin 108 germa “b” të K.Pr.Administrative përcaktohet se: “Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: **b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale;”, ndërsa në nenin 109 të K.Pr.Administrative përcaktohet se: “Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: **d) është në kundërshtim me ligjin material;**”**

17.2. Në pikën 5 të nenit “C”, “Dispozita të përgjithshme për Komisionin dhe Kolegjin e Apelimit” të Aneksit të Kushtetutës, të titulluar “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, parashikohet se anëtarët e Komisionit dhe gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit duhet të kenë jo më pak se 15 vjet përvojë si gjyqtar, prokuror, lektor i së drejtës, avokat, noter, jurist i nivelit të lartë në administratën publike, ose në profesione të tjera ligjore që lidhen me sistemin e drejtësisë.

17.3. Në nenin 6 të ligjit 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, parashikohet:

“Anëtar i Komisionit dhe gjyqtar i Kolegjit të Apelimit zgjidhet shtetasi shqiptar që plotëson kriteret e mëposhtme:

a) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligj;

b) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor i së drejtës, nëpunës i shërbimit civil në nivel drejtues ose në një përvojë të njohur në fushën e së drejtës administrative ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të ketë marrë një vlerësim të lartë për aftësitë e tij profesionale, etike dhe integritetin moral të tij, nëse u është nënshtruar vlerësimeve të mëparshme;

ç) nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike ose nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit;

d) ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, ose të mos ketë qenë subjekt i ndalimeve të parashikuara në ligjin “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit;

e) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish-shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

ë) nuk ka qenë gjyqtar, prokuror, këshilltar ligjor ose ndihmës ligjor gjatë dy viteve të fundit përpara kandidimit;

f) nuk ka qenë anëtar i Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, ose ekspert i caktuar nga partitë politike, si dhe Ministri i Drejtësisë;

g) nuk është më shumë se 65 vjeç;

gj) zotëron shumë mirë gjuhën angleze.

Përmbushja e kriterëve të mësipërme vlerësohet duke marrë në konsideratë në veçanti të dhënat si më poshtë:

a) titujt shkencorë në fushën e së drejtës;

b) përvojë të veçantë të kandidatit në sfera të caktuara të së drejtës;

c) vjetërsinë në profesion;

ç) përvojën studimore dhe profesionale jashtë shtetit shqiptar;

d) **notën mesatare jo më pak se 8, nëse ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave” në Shqipëri, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit, dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj.”**

16. **Shkeljet dhe mashtrimet në zgjedhjen e Anëtarit të KPA Ardian Hajdari**
Zgjedhja e anëtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit Ardian Hajdari është e paligjshme pasi është **shkelur parimi kushtetues i nenit 179/b paragrafi i parë dhe nuk ka plotësuar katër nga 5²² kriteret kushtetuese dhe ligjore lejuese për këtë pozicion.**

Së pari, për këtë person ka pasur informacione nga institucionet shtetërore për kryerjen e **veprimtarisë kriminale të Korrupsionit në Drejtësi**²³ gjatë kohës që ka ushtruar funksionin e avokatit. Për këtë shkak zgjedhja e tij ka cënuar drejtpërdrejt parimin themelor Kushtetues të procesit të rivlerësimit i parashikuar nga neni 179/b i Kushtetutës sipas së cilit “Sistemi i vlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit gjyqësor si dhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi”. Vendosija si anëtar i KPA -së, institucionit më të rëndësishëm dhe të vetëm me natyrë gjyqësore që do rivlerësojë gjyqtarët dhe prokurorët, e një individ të dyshuar për veprimtari kriminale të korrupsionit në drejtësi jo vetëm që nuk mund të garantojë kthimin e besimit të publikut te institucionet e drejtësisë por mund të cënojë rëndë imazhin e drejtësisë në Shqipëri, Bashkimin Evropian dhe në SHBA si dhe të humbasë plotësisht besimin e publikut në këto institucione. Ky individ nuk plotëson në këtë mënyrë dhe kriterin e parashikuar nga neni 6(c) të Ligjit nr. 84 të vitit 2016 sipas së cilit kandidati duhet të ketë marrë një vlerësim të lartë të aftësive të tij

²² Neni 6(1) gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “gj” të Ligjit nr. 84/2016.

²³ www://exit.al/2020/01/tjeter-komisioner-i-vetingut-i-akuzuar-per-probleme-te-figures/, aksesuar në 14.07.2020.

profesionale, etike dhe integritetin moral, nëse u është nënshtruar. Për shkak të përvojës si jurist në institucione me rëndësi të papërfillshme²⁴ nga pikëpamja juridike dhe marrëdhëniet me gjyqësorin nuk ka pasur vlerësime për aftësitë e tij profesionale dhe integritetin moral. Ndërsa për pjesën e përvojës së punës si avokat ka një vlerësim nga institucionet e shtetit shqiptar, që është Shërbimi Informativ i Shtetit që Ligji nr. 8391 datë 28.10.1998 e ngarkon me detyrën për të mbledhur informacion edhe lidhur me veprimtarinë korruptive të punonjësve të shërbimit publik përfshirë dhe në sistemin gjyqësor në Shqipëri.

Konkretisht, sipas informacionit, të transmetuar nga media elektronike²⁵, në vitin 2006 Shërbimi Informativ i Shtetit në zbatim të detyrimeve ligjore i ka dërguar Presidentit të Republikës shkresën nr. 3170 datë 27.12.2006, me objekt “*Mbi korrupsionin në sistemin e drejtësisë*”. Në këtë shkresë midis të tjera e ka informuar Presidentin se “*Gjatë vitit 2006, SHISH ka siguruar të dhëna për dyshime dhe marrëdhënie korruptive në sistemin e drejtësisë në të cilat evidencohen format, mekanizmat dhe autorët e tyre*”. Në faqen 12, paragrafi i tretë i kësaj shkrese, Presidenti i Republikës informohet se “*... gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor implikohet në korrupsion pasiv në çështje për rritje të moshës. Bashkëpunon me avokatin Ardian Hajdari si dhe babin e tij ... të cilët luajnë rolin e ndërmjetësit për personat që duan të rrisin moshën kundrejt përfitimit të 1500 deri 2000 euro*”.

Pra nga sa më sipër rezultojnë të dhëna të dokumentuara zyrtarisht që gjatë ushtrimit të profesionit të Avokatit është implikuar drejtpërdrejt në veprime korruptive të cilat përpëjnë jo vetëm shkelje të rëndë të etikës dhe integritetit moral të tij por edhe vepër penale, krimin e “**Korrupsionit aktiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarit të drejtësisë**”, parashikuar nga neni 319 i Kodit Penal. Pra ky individ ka dyshime të dokumentuara se ka kryer veprimtari kriminale gjatë ushtrimit të funksionit të avokatit, periudhë e cila ka shërbyer si vjetësi dhe përvojë profesionale në aplikimin për Anëtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ndërkohë që sipas nenit 6(1)(c) Ligjit nr. 84/2016 do të mjaftonte vetëm fakti që të mos kishte vlerësim të lartë etik dhe integritet të lartë moral që të mos zgjidhej në këtë funksion.

Së dyti, nuk plotëson kushtin e vjetërsisë në punë 15 vjet, sipas përcaktimeve të nenit C(5) të Aneksit të Kushtetutës, nenit 6(1)(b) të Ligjit nr. 84/2016. Kështu, referuar procesverbalit të Komisionit Ad Hoc të Kuvendit, të datës 02.06.2017, për përzgjedhjen e anëtarëve të Kolegjit të Apelit, rezulton se Ardian Hajdari ka deklaruar të dhëna të pavërteta, duke deklaruar se ka ushtruar funksionin e avokatit për 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet.²⁶ Për vërtetimin e përvojës së tij profesionale si avokat ai ka paraqitur 17 (shtatëmbëdhjetë) leje vjetore të lëshuara nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Ndryshe nga sa ka deklaruar në Komisionin Ad Hoc të Kuvendit, në CV-në e tij Ardian Hajdari ka deklaruar se ka ushtruar profesionin e avokatit nga viti 2002-2004, si dhe nga 2006 e në vazhdim. Nëse marrim të vërteta që dhënat e CV-së së tij, ai ka ushtruar profesionin e avokatit maksimumi për 13 vite.

²⁴ Sipas CV-së dorëzuar tek Avokati i Popullit, Jurist në Bashkinë e Vaut të Dejës dhe Jurist në Hidrocentralin e Komanit.

²⁵ ëëë://exit.al/2020/01/tjeter-komisioner-i-vingut-i-akuzuar-per-probleme-te-figures/, aksesuar në 14.07.2020.

²⁶ Shiko deklarimin e tij në faqen përkatëse të procesverbalit.

Pra, anëtari aktual i KPA Ardian Hajdari **gënjen ose para Komisionit Ad Hoc të Kuvendit ose në të dhënat që ka shënuar në CV-në e tij**. Në këto rrethana, Ardian Hajdari rezultoi të ketë deklaruar të dhëna të pavërteta para Kuvendit, duke treguar²⁷ se ka ushtruar profesionin e avokatit për 17 vjet. Duke pasur në konsideratë faktin që për deklaratimet para Komisioneve ad hoc të Kuvendit zbatohen parimet e përgjegjësisë penale për deklarim të rremë ai ka konsumuar elementët e veprës penale të “Dëshmisë së rremë” parashikuar nga neni 306 i Kodit Penal.

Përvoja tjetër profesionale e paraqitur në CV-në e tij, që është ndihmës gjyqtar, nuk përfshihet në grupin e profesioneve të parashikuara në nenin 6(1)(b) të Ligjit nr. 84/2016. Në këtë pikë duhet nënvizuar fakti se zotërimi i lejes apo liçencës për ushtrimin e profesionit, nuk vërteton ushtrimin faktik të profesionit. Kështu, konkretisht, edhe pse Ardian Hajdari ka pasur lejen e ushtrimit të profesionit të avokatit, në periudhën përgjatë viteve 2005-2006, ai nuk ka punuar si avokat, por si jurist në Bashkinë e Vaut të Dejes. Po kështu, përgjatë periudhës 06.11.2000-01.12.2001, referuar jetëshkrimit të tij, ai ka punuar si jurist pranë Hidrocentralit të Komanit. Vlen të theksohet se profesioni i avokatit, që përbën njëkohësisht edhe veprimtari ekonomike tregtare, veç lejes së ushtrimit të profesionit nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, ushtrohet vetëm pasi të jetë plotësuar edhe kushti tjetër ligjor, ai i regjistrimit në Zyrën e Tatim Taksave dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore të qytetit konkret. Kështu koha e fillimit të ushtrimit të profesionit të avokatit dhe kohëzgjatja përkatëse duhet të rezultojë nga të dhënat e pasqyruara në organet tatimore dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, të dhëna këto të dorëzuara nga subjekti tatimpagues, i regjistruar rregullisht dhe i pajisur me çertifikatën tatimore përkatëse. Konkretisht, në nenin 30, “Pajisja me çertifikatë tatimore”, të ligjit nr. 8560²⁸, datë 22.12.1999, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se: “1. Çdo person e fiton të drejtën të ushtrojë veprimtari ekonomike vetëm pasi të regjistrohet në gjykatë. Pas këtij regjistrimi, ai detyrohet të kërkojë pajisjen me çertifikatë tatimore. Kjo kërkesë paraqitet në degën e tatimeve të rrethit, ku personi ka selinë e veprimtarisë së tij...

2. Për t’u pajisur me çertifikatë tatimore duhet: a. Personat juridikë e fizikë me qarkullim vjetor më të madh se kufiri i regjistrimit për TVSH-në, sëbashku me kërkesën, duhet të paraqesin në organet tatimore, përveç vendimit të gjykatës që miraton regjistrimin e tyre, edhe statutin dhe aktin e themelimit, si dhe informacione kontakti për çdo përfaqësues të tatimpaguesit. b. Personat juridikë e fizikë me qarkullim vjetor nën kufirin e regjistrimit për TVSH-në, duhet të paraqesin vendimin e gjykatës që miraton regjistrimin e tyre dhe informacione kontakti për çdo përfaqësues të tatimpaguesit...

3. Tatimpaguesit e biznesit të vogël janë të detyruar të përsërisin çertifikatën tatimore çdo vit, siç përcaktohet në ligjin nr. 8313, datë 26.3.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, ndërsa tatimpaguesit e regjistruar për TVSH-në regjistrohen vetëm një herë në momentin e fillimit të veprimtarisë ekonomike”.

²⁷ Shiko faqen 31 të procesverbalit të datës 02.06.2017, ku pyetjes së deputetit Eduard Halimi, kandidati Ardian Hajdari i përgjigjet se ka punuar gati 17 vjet si avokat (që nga muaji maj i vitit 2000).

²⁸ Ligji i cili ka qenë në fuqi në momentin që z. Ardian Hajdari pretendon të ketë filluar të ushtrojë profesionin e avokatit.

Në dosjen e paraqitur pranë Avokatit të Popullit²⁹ nuk ka të dhëna se kur është regjistruar Ardian Hajdari në organet tatimore në aktivitetin privat si Avokat, por nga të dhënat publike të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit rezulton se ai është regjistruar për herë të parë në organet tatimore, për të ushtruar profesionin e avokatit, në datë 27.04.2007,³⁰ duke u pajisur me certifikatën tatimore me numrin unik të identifikimit të subjektit K76627002O. Nuk është kryer asnjë verifikim për këto fakte nga ONM, që sipas Kushtetutës dhe Ligjit, është organi shtetëror në Shqipëri që ka detyrimin ta kryejë këtë³¹. Bazuar në sa më lart, *përpara kësaj date Ardian Hajdari nuk ka qenë i regjistruar në organet tatimore, nuk ka paguar sigurimet shoqërore për ushtrimin e profesionit të avokatit dhe, si rrjedhojë, ai nuk vërteton ligjërisht që ka ushtruar funksionin përpara datës 27.04.2007, pra, nuk vërtetohet se ky shtetas ka të paktën 15 vjet përvojë pune si avokat.*

Në këto kushte, nëse Ardian Hajdari pretendon se ka ushtruar profesionin e avokatit në kundërshtim me ligjin, edhe përpara datës 27.04.2007, kjo periudhë jo vetëm nuk mund të përlllogaritet si përvojë profesionale apo vjetërsi pune, por ky fakt mund të provojë se ai ka shkelur gjatë kësaj periudhe legjislacionin tatimor, *duke kryer evazion fiskal dhe kështu jo vetëm ka vënë në dyshim integritetin e tij etik dhe moral por njëkohësisht ka kryer dhe veprën penale të “Mospagimit të taksave dhe tatimeve” parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal. Edhe për këtë fakt ONM nuk ka kryer asnjë verifikim, edhe pse një pjesë e këtyre verifikimeve mund të kryheshin nga zyra online, nëse është regjistruar si subjekt tatimor, kur është regjistruar, nëse i ka paguar detyrimet, etj.*

Së treti, Ardian Hajdari nuk plotëson kushtin e përfundimit të arsimit të lartë juridik me notë mesatare jo më pak se 8, sipas përcaktimeve të nenit C(5) të Aneksit të Kushtetutës, nenit 6(1)(a) dhe (2)(d) të Ligjit nr. 84/2016. Kështu në dosjen e dorëzuar prej tij pranë Avokatit të Popullit³² dhe të paraqitur më pas në Kuvend, rezulton se Ardian Hajdari ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në kursin e plotë përgjatë viteve 1992 – 1996³³, me mesatare 6.44³⁴. Sipas nenit 6(2) e ligjit nr. 84/2016 për verifikimin e plotësimit të kriterëve të pikës 1, pra nëse ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave” në Shqipëri, aplikanti duhet të ketë pasur notë mesatare jo më pak se 8. Është e pashpjegueshme se si Avokati i Popullit së bashku me dy vëzhguesit e ONM-së Theo Jacobs dhe Peter Ainsöoth dhe znj. Calavera e ka konsideruar të plotësuar kriterin e nenit 6(1)(a) pa marrë në konsideratë veçanarisht notën mesatare. Është e paqartë se çfarë të dhëne tjetër kanë marrë në konsideratë kur ky kandidat veç mesatares minimale nuk ka pasur titujt shkencorë në fushën e së drejtës, përvojë të veçantë në sfera të caktuara të së drejtës, apo përvojën studimore dhe profesionale jashtë shtetit shqiptar.

²⁹ Në momentin e kandidimit për në institucionet e rivlerësimit, sipas studimit të Shoqatës lexferenda.

³⁰ Bashkëlidhur certifikata tatimore nga ëeb.

³¹ Neni B(3)(a) dhe C(7) e Aneksit të Kushtetutës detyron ONM të bëjë verifikime dhe t'i japë rekomandime Kuvendit lidhur me kualifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për pozicionet e anëtarit të Komisionit, gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe Komisionerit Publik.

³² Sipas CV-së.

³³ Bashkëlidhur kopje e diplomës e publikuar tek lex ferenda.

³⁴ Bashkëlidhur kopje e listës së notave.

Së katërtri, Ardian Hajdari nuk plotëson kushtin e **zotërimit shumë mirë të gjuhës angleze**, sipas përcaktimeve të nenit 6(1)(gj) të Ligjit nr. 84/2016. Në dosjen e tij nuk ka asnjë dokument që të provojë plotësimin e këtij kushti si dhe faktin nëse është verifikuar plotësimi i tij nga ONM-ja dhe në çfarë mënyre. *Ky është një fakt që mund të verifikohet dhe mund të verifikohet shumë lehtë nga ONM-ja.*

- 17. Shkeljet dhe mastrimet në zgjedhjen e Anëtares së KPA Rezarta Schuetz**
- Zgjedhja e anëtares së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit Rezarta Schuetz *është e paligjshme pasi është shkelur kriteri i përvojës së punës jo më pak se 15 vjet sipas parashikimeve të nenit C(5) të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 6(1)(b) e Ligjit nr. 84/2016.* Konkretisht nuk ka pasur 15 vjet përvojë në funksionet dhe profesionet e parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji si gjyqtare, prokurore, lektore e së drejtës, avokate, notere, juriste e nivelit të lartë në administratën publike, ose profesione të tjera që lidhen me sistemin e drejtësisë. Sipas CV-së ka pasur këtë përvojë pune:
- 03.1993 deri në 08.1996 këshilltare ligjore në Ministrinë e Bujqësisë.
 - 12.1997 deri në 08.1998 këshilltare ligjore e misionit të BE të asistencës në Dogana.
 - 08.1998 deri në 10.2000 këshilltare ligjore te Dhoma e Avokatëve Amerikanë.

Punët e kryera nga kjo kandidate në Shqipëri deri në vitin 2000 **nuk hyjnë në kategoritë e atyre që kërkon neni C(5) e Aneksit të Kushtetutës** dhe neni 6(1)(b) e Ligjit nr. 84/2016, si përvojë 15 vjeçare.

Nga viti 2000 deri në momentin e aplikimit ka punuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në Kosovë dhe në Republikën e Maqedonisë Veriore. Konkretisht:

- 10.2000 deri në 10.2008 zyrtare ligjore³⁵, Departamenti i Drejtësië, UNMIK, Kosovë.
- 05.2010 deri në momentin e aplikimit: zyrtare, punonjëse, në Zyrën e OSBE, Shkup.

Përvoja e mësipërme e pretenduar e kandidates për vjetësi pune jashtë territorit të Shqipërisë **nuk është parashikuar në asnjë nga kërkesat e Kushtetutës dhe Ligjit.** Madje në dosjen e dorëzuar për aplikim³⁶ nuk ka dokumenta që të provojnë këtë fakt, vjetërsinë. Ndodhen disa dokumenta të lëshuara nga institucione të huaja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Por këto dokumenta nuk kanë asnjë vlerë juridike para institucioneve të shtetit shqiptar pasi nuk janë paraqitur në formën e kërkuar nga ligji, janë dokumenta pa vulë apostile të vendit ku janë lëshuar, të papërkthyer dhe noterizuar nga noteri publik sikurse e kërkon Ligji Shqiptar, rrjedhimisht nuk kanë asnjë vlerë provuese për faktet që pretendon aplikantja. Pra, në kushtet kur një akt shkresor është mbajtur dhe lëshuar në territorin e një shteti tjetër si dhe në gjuhë të huaj, duhet të respektohen elementët formalë për vlefshmërinë e tij në Shqipëri sipas parashikimeve të Konventës e Hagës datë 5 tetor 1961, si dhe parashikimet e nenit 266 të Kodit të Procedurës Civile, i cili kërkon që *“Kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë*

³⁵ Term që nuk lidhet me asnjë nga funksinet e parashikuara nga neni C(5) e Aneksit të Kushtetutës

³⁶ Vërtetim i Avokatit të Popullit nr. 110/1 datë 20.03.2017.

me përkthimin e saj në gjuhë shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent.”

Këtë qëndrim ka mbajtur vetë anëtarja e KPA-së Rezarta Schuetz në disa vendime³⁷, si anëtare e trupave gjyquese, në rastet ku Gjyqtarët dhe Prokurorët në procesin e rivlerësimit kanë paraqitur dokumenta të lëshuara nga institucione jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë duke u shprehur se *nuk kanë asnjë vlerë provuese për faktet e pretenduara nga subjektet pasi nuk janë paraqitur në mënyrën e kërkuar nga Ligji Shqiptar*. Ndërsa vetë kjo anëtare e KPA ka paraqitur para Institucioneve të shtetit Shqiptar, Presidentit dhe Avokatit të Popullit dokumentat të lëshuara nga institucione të vende të tjera ose në gjuhë të huaj për të provuar vjetërsinë në punë. *Duke qenë se këto dokumenta nuk kanë asnjë vlerë, sikurse vetë ajo mendon dhe ka vendosur, ajo nuk plotëson kriterin kushtetues dhe ligjor të vjetërsisë në punë prej 15 vjetësh, ndaj dhe zgjedhja e saj është e paligjshme.*

Për shkaqet e mësipërme anëtarja aktuale e KPA-së Rezarta Schuetz, është skualifikuar nga Avokati i Popullit, për mosplotësim të kriterëve formale. Konkretisht³⁸ në dokumentin e verifikimit të kriterëve dërguar Kuvendit shprehet se “Ka aplikuar për pozicionin gjyqtare e Kolegjit të Apelimit, mungojnë dokumentat si më poshtë ...” radhit një sërë dokumentash dhe në pikën e fundit shprehet “...Nga dokumentacioni i paraqitur nuk vërtetohet kriteri i vjetërsisë në punë sipas gjermës “b”, pika 1 e ligjit nr. 84/2016”. Ky vlerësim është mbështetur edhe nga ONM-ja dhe së bashku e kanë dërguar në Kuvend tek listën e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret për tu zgjedhur. Por Kuvendi pa kryer asnjë hetim mbi vlefshmërinë ligjore dhe provueshmërinë e dokumentave të paraqitura nga aplikantja, me qëndrim të pastër politik dhe pa asnjë të dhënë apo provë të re si dhe argument juridik, me shumicë të cilësuar, e ka kaluar atë nga lista “B” (të skualifikuarit), tek lista “A” (të kualifikuarit, të gatshëm për votim).

18. Shkeljet dhe mashtrimet në zgjedhjen e Anëtares së KPA Natasha Mulaj.

Edhe zgjedhja e anëtares së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit **Natasha Mulaj** është e paligjshme pasi janë shkelur kriteri i përvojës së punë jo më pak se 15 vjet, kriteri i përfundimit të Ciklit të dytë të Studimeve Universitare për Drejtësi me notë mesatare jo më pak se 8 dhe kriteri i zotërimit shumë mirë të gjuhës angleze sipas parashikimeve të nenit C(5) të Aneksit të Kushtetutës nenit 6(1)(a), (b), (g) dhe (2)(d) të Ligjit nr. 84/2106.

Konkretisht nuk ka pasur 15 vjet përvojë në funksionet dhe profesionet e parashikuara nga neni C(5) të Aneksit të Kushtetutës si gjyqtare, prokurore, lektore e së drejtës, avokate, notere, juriste e nivelit të lartë në administratën publike, ose profesione të tjera që lidhen me sistemin e drejtësisë. Referuar CV-së³⁹, si dhe dhe procesverbalit përkatës të pyetjes së saj në Kuvend, rezulton se znj. Natasha Mulaj, ka ushtruar këto detyra:

³⁷ Vendimi i KPA nr. 32 datë 21.11.2019 paragrafët 42, 55, 69 dhe 72.1; Vendimi i KPA nr. 6 datë 28.02.2029 paragrafi 20.13 e në vazhdim.

³⁸ Faqe 123 e dosjes “Shënime mbi kandidatët që nuk kanë përmbushur kriteret formale”.

³⁹ Dorëzuar pranë Avokatit të Popullit.

1. Nga viti 1993-2000, ka punuar si ndihmës gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Referuar librezës së saj të punës, nga 8 Maj 1993-27 maj 2000, pra, për 7 vjet e 19 ditë;
2. Nga viti 2000-2007, ka pretenduar se ka punuar si gjyqtare në po këtë gjykatë. Në të vërtetë, rezulton se ajo e ka ushtruar detyrën e gjyqtares për një periudhë prej 2 (dy) vjet e 1 (një) muaj⁴⁰, sepse është larguar jashtë vendit për arsye personale familjare⁴¹;
3. Nga data 16.11.2007- 09.04.2013, ka punuar si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë, pra, për 5 (pesë) vjet, 4 (katër) muaj e 23 (njëzet e tre) ditë.
Duhet evidentuar fakti që znj. Natasha Mulaj ka kryer studimet në ciklin pa shkëputje nga puna (korespondencë) në periudhën 1992 deri në vitin 1996. Pra para vitit 1996 nuk ka qenë juriste dhe rrjedhimisht nuk mund të pretendohet vjetërsi pune me këtë status. Puna si ndihmës gjyqtar nuk hyn në kategoritë e atyre që kërkon neni C(5) e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 6(1)(b) e Ligjit nr. 84/2016, si përvojë 15 vjeçare. Por edhe nëse do ta konsideronin si përvojë, duke e llogaritur nga viti 1996 kur është diplomuar Juriste, **nuk mund të jetë më shumë se 4 vjet.** Për periudhën 2000-2007 znj. Natasha Mulaj ka punuar si gjyqtare vetëm 2 (dy) vjet e 4 (katër) muaj, fakt që provohet dhe me kërkesën dhe dosjen e paraqitur prej saj për pozicionin e Inspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë⁴². Pikërisht për shkak të mungesës së përvojës prej pesë vjet si gjyqtare, znj. Natasha Mulaj është skualifikuar edhe nga gara për t'u emëruar si inspektore pranë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në vitin 2015, fakt që vërtetohet edhe nga procesverbali përkatës datë 03.02.2016 i komisionit të shqyrtimit të kandidaturave i ngritur për këtë qëllim. Po ashtu provohet edhe me shënimin që kandidatja ka bërë me shkrimin e saj në formularin e dorëzuar ku thekson që nga viti 2002 e në vazhdim nuk ka ushtruar funksionin e Gjyqtares. Konkretisht kandidatja ka bërë shënimin “... për periudhën 2002 -2007 unë nuk jam paguar si gjyqtare pasi për arsye objektive të miat kam qenë me lejë (4 vite e gjysëm) nga KLD, por statusi im si gjyqtare ka qenë status pasiv. Edhe sot që shkruaj statusi im është akoma ai i gjyqtares. Në vitin 2000-2002 jam paguar rregullisht pasi kam gjykuar çdo ditë çështje penale dhe civile pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tropojës. Kërkesat në KLD kanë qenë çdo mbledhje por nuk u bë e mundur rifutja edhe një herë në detyrën e gjyqtares. Pastaj fillova në Gjykatën e Lartë...”. Pra kandidatja vetë ka pranuar dhe ka shpjeguar që vetëm në periudhën 2000 (24.07.2000) deri në 2002 (16.08.2002 ku i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare) ka punuar si gjyqtare. Pra në konkluzion, lidhur me përvojën profesionale, znj. Mulaj ka një periudhë prej 2 (dy) vjet e 1 (një) muaj si Gjyqtare në Tropojë dhe 5 (pesë) vjet, 5 (pesë) muaj si ndihmëse ligjore të Gjykatën e Lartë, rezulton se ajo ka përvojë pune, sipas kësaj pike, **vetëm 7 (shtatë) vjet 6 (gjajshtë) muaj.** Megjithatë, edhe sikur në përvojën e saj të përfshihej edhe puna e saj si ndihmës gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Tropojë, sërish kandidatja nuk e plotëson kushtin prej 15 vitesh përvojë pune

⁴⁰ Shkresa nr. 590/1 datë 06.02.2020 e Këshillit të Lartë Gjyqësor dërguar kërkuarit, kthim përgjigje dhe dërgim aktesh.

⁴¹ Vërtetim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë datë 28.05.2013 sipas së cilit znj. Natasha Mulaj është emëruar Gjyqtare në këtë Gjykatë në datën 24.07.2000 dhe është paguar me pagë mujore 45084 lekë deri në datën 16.08.2002, dërguar nga KLGJ me shkresën nr. 590/1 datë 06.02.2020.

⁴² Sipas procesverbalit të datës 03.06.2016 të mbledhjes së Komisionit për shqyrtimin e kandidaturave për emërim Inspektori, ku është shqyrtuar kjo kërkesë, dërguar nga KLGJ me shkresën nr. 590/1 datë 06.02.2020.

si gjyqtare, pasi gjithsej i bëhen vetëm 11 (njëmbëdhjet) vjet, 6 (gjashtë) muaj. Por edhe do i shtonim periudhën para vitit 1996, **kur nuk qenë as juriste**, përsëri nuk plotëson vjetërsinë prej 15 vjetësh.

Vlen të theksohet se, me datë 17.02.2017, Avokati i Popullit, pasi ka bërë verifikimet e kushteve të zgjedhshmërisë, i ka përcjellë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit listat e kandidatëve, nga ku rezulton se vetëm 29 (njëzet e nëntë) aplikantë, nga 163 gjithsej, i plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore për t'u zgjedhur në institucionet e rivlerësimit. Më pas, në datën 03.03.2017, Avokati i Popullit i ka përcjellë Kuvendit të dy listat e sipërcituara, së bashku me rekomandimet e ONM-së. **Emri i znj. Natasha Mulaj përfshihej në listën e kandidatëve që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret formale.** Me datë 17.03.2017, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë e ka kthyer edhe një herë çështjen tek Avokati i Popullit sipas Vendimit nr. 18/2017 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Pas kësaj, me datë 30.03.2017, Avokati i Popullit i ka përcjellë Kuvendit dy lista, njëra me 84 (tetëdhjetë e katër) kandidatë që i plotësojnë kushtet dhe kriteret, si dhe tjetra me 109 kandidatë që nuk i plotësojnë ato. **Emri i znj. Natasha Mulaj, pavarësisht se nuk është qartësuar se çfarë veprime të tjera janë kryer, tashmë përfshihej në listën e kandidatëve që i plotësojnë kushtet dhe kriteret formale.** Nuk ka asnjë shpjegim se përse një kandidat që nuk i plotësonte kushtet herën e parë, ndër to edhe Natasha Mulaj, i plotësonte këto kushte një muaj më pas.

Po ashtu Anëtarja aktuale e KPA Natasha Mulaj **nuk plotëson kushtin e përfundimit të Ciklit të Dytë të Studimeve Universitare për Drejtësi me notë mesatare jo më pak se 8, sipas përcaktimeve të nenit 6(1)(a) dhe (2)(d).** Rezulton që ajo ka mbaruar Fakultetin e Drejtësisë Tiranë në vitin 1996 në sistemin pa shkëputje nga puna. **Në dokumentat e paraqitura prej saj gjatë aplikimit për anëtare të KPA nuk rezulton asnjë e dhënë se me çfarë mesatare i ka mbaruar studimet.** Është e pashpjegueshme se si Avokati i Popullit së bashku me dy vëzhguesit e ONM-së Theo Jacobs dhe Peter Ainsöoth dhe znj. Calavera e ka konsideruar të plotësuar kriterin e nenit 6(1)(a) pa marrë në konsideratë veçanarisht notën mesatare. Çfarë të dhëne tjetër kanë marrë në konsideratë kur nuk dihet mesatarja si dhe nuk ka pasur titujt shkencorë në fushën e së drejtës, përvojë të veçantë në sfera të caktuara të së drejtës, apo përvojën studimore dhe profesionale jashtë shtetit shqiptar?

Gjithashtu znj. Natasha Mulaj ka përfunduar **studimet për drejtësi me korrespondencë, në sistemin pa shkëputje nga puna, pa informacion rreth mesatares,** me përvojë punë jo vetëm të pamjaftueshme sipas kërkesave kushtetuese dhe ligjore por edhe në funksione të tilla që nuk tregojnë dhe garantojnë një jurist me aftësi të larta profesionale dhe vlerësim të lartë etike dhe integritet moral. Në këtë mënyrë veçse është shkelur neni 6(1)(c) i Ligjit nr. 84/2016 është shkelur dhe parimin themelor Kushtetues i procesit të vetingut i parashikuar nga neni 179/b i Kushtetutës sipas së cilit “Sistemi i vlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit gjyqësor si dhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi”. Pra nuk mund të kthehet besimi i publikut të gjyqtarët dhe prokurorët kur këta do të vlerësohen nga një individ, i cili **jo vetëm nuk plotëson kriteret formale të vjetërsisë në punë**

por edhe nuk gëzon statusin e një juristi që të garantojë aftësi të larta profesionale dhe etike dhe integritet të lartë moral.

Së fundi, znj. Natasha Mulaj nuk plotëson kushtin e zotërimit shumë mirë të gjuhës angleze, sipas përcaktimeve të nenit 6(1)(gj) të Ligjit nr. 84/2016. Në dosjen e saj nuk ka asnjë dokument që të provojë plotësimin e këtij kushti si dhe nëse është verifikuar plotësimi i tij nga ONM e në çfarë mënyre. *Ky është një fakt që mund të verifikohet dhe mund të verifikohet shumë lehtë nga ONM.* Të gjitha faktet e mësipërme përvoja, mbarimi i shkollës dhe gjuha e huaj, mund të verifikoheshin lehtësisht nga ONM-ja e cila ka pasur dhe detyrimin ligjor dhe nuk i ka kryer këto veprime.

19. Shkeljet dhe konflikti i interesit në zgjedhjen e Anëtares të KPA Albana Shtylla

Zgjedhja e anëtares së KPA Albana Shtylla është e paligjshme pasi është shkelur kriteri që të mos ketë **mbajtur funksione politike sipas parashikimeve të nenit C(5) të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 6(1)(ç) e Ligjit nr. 84/2016.** Konkretisht kjo aplikante në funksionin e Sekretares së Përgjithshme të Kuvendit të Shqipërisë në vitet 2014-2017, në emër të Kuvendit ka ushtruar funksion politik duke mbajtur komunikimet me Bashkimin Europian, SHBA, Avokatin e Popullit dhe ONM-në lidhur me procesin e Vetëgënjimit në Shqipëri⁴³ dhe zgjedhjen e anëtarëve të Institucioneve të rivlerësimit, përfshirë dhe KPA-në ku dhe vetë u zgjodh. Po ashtu është shkelur neni 6(1)(f) e Ligjit nr. 84/2016 pasi nuk ka plotësuar në thelb kushtin për të mos qenë pjesëmarrës kryesor në procesin e Reformës në Drejtësi. Duke u propozuar nga Kuvendi, i cili përbëhet nga përfaqësues të Partive Politike, në thelb është propozuar nga Partitë Politike.⁴⁴

Pikërisht anëtarja aktuale e KPA-së Albana Shtylla, si **përfaqësuese politike e Kuvendit,** ish-Ministri i Jashtëm Ditmir Bushati, ish-Ministrja e Integritetit të Shqipërisë Klajda Gjoshja si dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave Engjëll Agaçi njoftohen prej Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme për Fqinjësi dhe Zgjerim të Bashkimit Europian Christian Danielson, me letrën e datës 26.01.2017, lidhur me pranimin nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës⁴⁵ të kërkesës së Qeverisë Shqiptare për krijimin Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit me qëllim monitorimin e zbatimit të procesit të Vetëgënjimit në Shqipëri. Po ashtu autoritetet politike në Shqipëri, përfshirë znj. Albana Shtylla, informohen dhe për arritjen e marrëveshjes politike midis BE dhe SHBA për monitorimin e përbashkët të procesit të vetëgënjimit në Shqipëri dhe se ky mision do të kryesohej nga z. Genoveva Ruiz Calavera, Drejtore për Ballkanin Perëndimor në Bashkimin Europian. Pra rezulton që institucionet politike të Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga z. Engjëll Agaçi, Ministria e Jashtëme, përfaqësuar nga z. Ditmir Bushati, Ministria e Integritetit, përfaqësuar nga zj. Klajda Gjoshja dhe Kuvendi i Shqipërisë, përfaqësuar nga zj. Albana Shtylla, i kanë

⁴³ Letra e datës 26.01.2017 që Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme për Fqinjësi dhe Zgjerim Christian Danielson i dërgon autoriteteve Shqiptare. Fqim

⁴⁴ Neni 6(1)(f) e Ligjit nr. 84/2016 "Nuk ka qenë....ekspert i caktuar nga Partitë Politike...".

⁴⁵ Marrëveshja midis Departamentit të Shtetit të SHBA dhe Bashkimit Europian "për bashkëpunimin në misionin Ndërkombëtar të Monitorimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të Gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri" firmosur në datën 02.09.2016 nga SHBA dhe në datën 01.11.2016 nga BE.

paraqitur kërkesë Bashkimit Evropian për monitorimin e zbatimit të procesit të vetingut dhe Bashkimi Evropian pasi e ka pranuar kërkesën në datën 26.01.2017 informon për këtë fakt këto autoritete politike, përfshirë Sekretaren e Përgjithshme të Kuvendit të Shqipërisë Albana Shtylla. Komunikimi i Zyrtarit të lartë politik të Bashkimit Evropian me zyrtarët më të lartë politikë të Shqipërisë është vetëm një komunikim politik. Aplikantja Albana Shtylla, në funksionin e Sekretarës së Përgjithshme të Kuvendit të Shqipërisë, ka marrë pjesë drejtpërdrejtë në këtë veprimtari politike.

Të njëjtë gjë bën dhe Zonja Genoveva Ruiz Calavera⁴⁶, **në funksionin e saj politik në Bashkimin Evropian si Drejtore për Ballkanin Perëndimor**, tashmë si kryesuese e Misionit Ndërkombëtar të Monitorimit, kur në datën 07.02.2017 informon Drejtorin e Përgjithshëm të BE për Fqinjësinë dhe Zgjerim dhe njëkohësisht autoritetet kryesore politike në Shqipëri Ministrin e Jashtëm, Ministrin e Integritetit dhe Kuvendin e Shqipërisë, përfaqësuar nga znj. Albana Shtylla, se misioni i BE dhe SHBA për monitorimi i procesit të vetingut në Shqipëri ishte gati. Po ashtu informon lidhur me pjesëmarrësit në këtë proces nga vendet e BE dhe nga SHBA si dhe detaje të tjera të rëndësishme. Në paragrafin e fundit znj. Calavera informon autoritet kryesore politike në BE dhe në Shqipërisë se ekspertet e këtij misioni janë gati të kontribuojnë në vlerësimin përfundimtar të kandidaturave për t'u emëruar në Instiucionet e Vetëingut. Pra znj. Calavera informoi znj. Shtylla se do të ishte ajo që do të bënte verifikimin përfundimtar të saj kur të aplikonte për t'u bërë pjesë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në bazë të nenit 7(5)-(7) të Ligjit nr. 84/2016. Në këtë mënyrë Drejtuesja e ONM-së e ka vendosur, që në këtë moment, në një konflikt të pastër interesi veprimtarinë e këtij institucioni në Shqipëri lidhur me verifikimin e kriterëve të aplikantës Albana Shtylla.

Po ashtu në funksion politik të përfaqësues së Kuvendit Albana Shtylla ka komunikuar⁴⁷ dhe me Avokatin e Popullit dhe ONM-në në muajt shkurt deri prill të vitit 2017 gjatë kryerjes së procedurave të verifikimit të kriterëve të aplikantëve për anëtarë të institucioneve të rivlerësimit. Pavarësisht se edhe vetë kishte aplikuar për anëtarë të KPA-së ajo ka vazhduar komunikimet me qëllim verifikimin e faktit nëse vetë ajo i plotësonte kriteret ose jo. **Veprim i pastër në konflikt interesi, ushtrimi i një detyre publike për zgjidhjen e një çështjes kur ajo vetë kishte interes të drejtpërdrejtë në rezultatin përfundimtar.** Ndërkohë që në komunikimet⁴⁸ e tij për këtë proces dhe në të njëjtën periudhë Avokati i Popullit i drejtohet Kryetarit të Kuvendit Z. Ilir Meta.

Gjithashtu znj. Shtylla ka qenë **anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përfaqësuese e Partisë Socialiste**⁴⁹ dhe në vitin 2013 me urdhër të PS e braktisi detyrën së bashku me dy përfaqësuesit e tjerë të PS. Pra ka qenë në një funksion dhe ka mbajtur qëndrim të qartë politik. Pra një individ që ka mbajtur funksione dhe qëndrime të pastra politike, duke qenë plotësisht aktiv politikisht jo vetëm në

⁴⁶ Letra e Znj. Genoveva Ruiz Calavera datë 26.01.2017 për Drejtorin e Përgjithshëm të BE për Fqinjësinë dhe Zgjerimin dhe Autoritetet politike në Shqipëri.

⁴⁷ Shkresat e Kuvendit nr. 811/5 datë 07.03.2017, nr. 811/6 datë 10.03.2017, nr. 811/9 datë 15.03.2017. nr. 938 datë 17.03.2017 dërguar Avokatit të Popullit.

⁴⁸ Shkresa Avokatit të Popullit nr. 57 datë 03.03.2017 dhe nr. 104 datë 07.04.2017 dërguar Kuvendit.

⁴⁹ [http://www.respublica.al/content/albana-shtylla-dhe-denar-biba-dy-emrat-e-ps-p%C3%ABr-n%C3%AB-kqz,aksesuar më 15.07.2020.](http://www.respublica.al/content/albana-shtylla-dhe-denar-biba-dy-emrat-e-ps-p%C3%ABr-n%C3%AB-kqz,aksesuar-më-15.07.2020)

procesin e inicimit dhe krijimit të institucioneve të kryerjes së vetingut në Shqipëri por edhe në vlerësimin e kandidatave konkrete, ku ka qenë edhe vetë, në kundërshtim të qartë me nenin 6(1)(ç) të Ligjit nr. 84/2016 zgjidhet anëtar i institucionit më të lartë të Vetingut.

Gjithashtu kjo kandidate është zgjedhur në shkelje të kushtit të parashikuar nga neni 6(1)(f) i Ligjit nr. 84/2016. Ajo nuk ka qenë **anëtare e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë por Drejtuese e Sekretariatit Teknik për Reformën në Drejtësi.**

Por cili ka qenë në thelb funksioni i Grupit të Ekspertëve të Lartë dhe i Sekretariatit Teknik? Të dyja këto struktura kanë punuar së bashku, si një trupë⁵⁰. Madje nëse Ekspertët e Lartë propozoheshin nga institucionet e drejtësisë si Gjykata e Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, Shkolla e Magjistraturës etj., Drejtuesja e Sekretariatit Teknik është propozuar nga një organ i pastër politik, si Komisionit Parlamentar i Reformës në Drejtësi i përbërë nga përfaqësues të partive politike dhe i drejtuar nga deputeti i Partisë Socialiste Z. Fatmir Xhafaj, pra në thelb e zgjedhur nga partitë politike. Kanë qenë ekspertët dhe anëtarët e Sekretariatit Teknik, personat që kanë materializuar reformën nëpërmjet projektligjeve apo projektamendamente kushtetuese që kanë përgatitur. Nuk ka asnjë shpjegim pse Ligji 84/2016 i përjashton Ekspertët dhe Jo anëtarët e Sekretariatit Teknik e aq më shumë Drejtuesen nga zgjedhja në organeve të ardhshme të drejtësisë së re.

Në fakt ka një shpjegim të thjeshtë që vetë drejtuesja e Sekretariatit Teknik për Reformën në Drejtësi do të kandidonte më vonë për anëtare të Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Pra kjo kandidate ka qenë një nga aktorët kryesorë në përgatitjen e Amendamenteve të Kushtetues dhe të Ligjit që parashikuan institucionin dhe mënyrën e ndërtimit të tij, ku kishte planifikuar të punonte në të ardhmen. Pra në thelb konflikti i interesit, nga ku është nisur ligjëbërësi dhe ligjvënësi për të vendosur këtë kufizim, është i njëjtë edhe për kandidaten dhe anëtares aktuale të KPA Albana Shtylla sikurse edhe për Ekspertët e Lartë.

Lidhur me znj. Albana Shtylla ka dyshime, të pasyruara nga media,⁵¹ se në punimin i saj të Doktoraturës **ka kopje, plagjaturë**. Dyshimi rreth këtij fakti përbën çënim të rëndë të figurës morale të një Anëtarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe nëse do të vërtetohej edhe veprën penale të vjedhjes.

20. Shkeljet dhe konflikti i interesit në zgjedhjen e Anëtarit të KPA Sokol Çomo
Zgjedhja e anëtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit Sokol Çomo është e paligjshme pasi është shkelur neni C(5) i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 6(1)(ç) dhe (f) e Ligjit nr. 84/2016 pasi ka ushtruar funksione politike dhe nuk ka plotësuar në thelb kushtin për të mos qënë pjesëmarrës kryesor në procesin e Reformës në Drejtësi. Duke u propozuar nga Kuvendi, i cili përbëhet nga përfaqësues të Partive Politike, është propozuar politikisht.

⁵⁰ Në të njëjtën ditë, për të njëjtën arsye dhe të njëjtin rol janë krijuar: Vendimi nr. 7, dt. 23.01.2015, "Për miratimin e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar"; Vendimi nr. 8, dt. 23.01.2015 "Për miratimin e organigramës së Sekretariatit Teknik" dhe Vendimi nr. 12, dt. 2.04.2015, "Për ngritjen dhe drejtimin e grupeve të punës me ekspertët e nivelit të lartë".

⁵¹ https://ëëë.cna.al/2019/01/27/plagjiaturat-lista-e-plote-me-emrat-e-doktoranteve-kopjues/,_aksesuar_më_15.07.2020.

Në thelb si për kandidaten Albana Shtylla edhe kandidati Sokol Çomo është zgjedhur në shkelje të kushtit të parashikuar nga nenin 6(1)(f) e Ligjit nr. 84/2016. Ky i fundit nuk ka qenë pjesë e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë por ka qenë konsulent i jashtëm i këtij Grupi. Kuvendi me Vendimin nr. 12, dt. 2.04.2015⁵², “Për miratimin e ekspertëve si konsulentë të jashtëm pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar”⁵³ ka miratuar si konsulentë të jashtëm pranë Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë 7 (shtatë) ekspertë të përcaktuar me emra midis të cilëve dhe aplikantin Sokol Çomo. Në thelb, pavarësisht triblimeve dhe emrin që i ka vendosar Kuvendi, roli i këtij kandidati në Reformë ka qenë i njëjtë me atë të Ekspertëve të Lartë. Madje nëse Ekspertët propozohen nga Institucionet e Drejtësisë aplikanti Sokol Çomo është propozuar nga Deputeti i Partisë Socialiste Z. Fatmir Xhafa dhe është miratuar nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi me shumicë të anëtarëve deputetë të partisë Socialiste, pra konsiderohet i caktuar nga Partitë Politike.

Përsëri lind pyetja pse Ligji nr. 84/2016 përjashton Ekspertët e Lartë dhe Jo Konsulentet e Jashtëm të Ekspertëve të Lartë në zgjedhjen e organeve të ardhshme të drejtësisë së re? Edhe në këtë rast përgjigja është e thjeshtë sepse vetë Konsulenti i Jashtëm i Ekspertëve të Lartë për Reformën në Drejtësi, Sokol Çomo, do të kandidonte më vonë për anëtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Pra ky aplikant duke qenë edhe një nga aktorët kryesorë në përgatitjen e Amendamenteve të Kushtetutës dhe të Ligjit që ka parashikuar institucionin dhe mënyrën e ndërtimit të tij, ku kishte planifikuar të punonte në të ardhmen. Pra në thelb konflikti i interesit, nga ku është nisur ligjëbërësi dhe ligjvënësi për të vendosur këtë kufizim, është i njëjtë edhe për kandidatin dhe anëtarin aktual të KPA Sokol Çomo sikurse edhe për Ekspertët e Lartë.

Duke analizuar nenin 6(1)(f) të Ligjit nr. 84/2016 konstatojmë që ai përjashton nga kandidimi dy kategori personash: Ekspertët e Lartë pranë Komisionit Parlamentar të Reformës në Drejtësi dhe ata Ekspertë të çfarëdo kategorie qofshin të caktuar nga partitë politike. **Aplikantët për në KPA Albana Shtylla dhe Sokol Çomo janë të përjashtuar sipas të dy kritereve.**

- Në thelb funksioni i tyre ka qenë i njëjtë me atë të Ekspertëve të Lartë,
- Dhe të dy, si ekspertë të çfarëdo lloj kategorie, janë propozuar nga partitë politike drejtpërsëdrejti dhe në përmbajtje të procesit të propozimit.

Po ashtu bindjen e plotë që aplikanti Sokol Çomo është një individ që përfaqëson interesin politik të Partisë Socialiste e krijon edhe fakti që ka mbajtur funksion të pastër politik, Zv/Ministër i Drejtësisë, gjatë qeverisjes së kësaj force politike në vitin 1998-2000. Në këtë kuadër shpjegohet dhe fakti se pse Kushtetuta dhe Ligji nr. 84/2016 përjashton kandidatët që kanë mbajtur **funksione politike 10 vitet e fundit dhe jo 15 apo 20**. Natyrisht kandidati, si konsulent i mazhorancës në Reformën për drejtësi, në vendosjen e këtij afati **ka pasur parasysh veten e tij**.

Z. Sokol Çomo dhe zj. Albana Shtylla po ashtu janë zgjedhur anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nga Parlamenti me propozim të Partisë Socialiste. Pra kanë

⁵² Vendim i Komisionit të Reformës në Drejtësi ku ka qenë kryetar Z. Fatmir Xhafaj, i njëjti person politik ish Ministër Drejtësie, që e ka marrë aplikantin Sokol Çomo edhe si Zv/Ministër të Drejtësisë gjatë viteve 1998-2000.

⁵³ Vendim i paaksesueshëm për publikun.

ushtruar një funksion të propozuar politikisht. Zoti Çomo të dy herët kur është zgjedhur anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, 2002-2007 dhe 2013-2016, është propozuar nga Parlamenti, me shumicë të Partisë Socialiste. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin e saj nr. 14 datë 22.05.2006 duke shqyrtuar çështjen lidhur me faktin nëse **anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë që zgjidhen nga Kuvendi nuk duhet të jenë gjyqtarë** konstaton se një parashikim i tillë ligjor nuk vinte në kundërshtim me Kushtetutën. Konkretisht Gjykata Kushtetuese konkludon se: *“Koncepti i vetëqeverisjes së gjyqësorit gjen shprehjen e vet jo vetëm në kuadrin e ndarjes së pushteteve, por edhe në bashkëveprimin e tyre. Prandaj, vështirë se mund të pranohet se ka cenim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve kur një pushtet krijon organe të pushtetit tjetër ose siguron të ardhurat për buxhetin e një pushteti tjetër. Duke u nisur nga nevoja e bashkëveprimit midis pushteteve, vetëqeverisja e gjyqësorit nuk mund të realizohet siç kërkohet pa respektuar parimin e demokracisë, pra pa dëgjuar e vlerësuar edhe vullnetin e sovranit që shfaqet jo vetëm kur ai miraton ligjet e organizimit e të funksionimit të organeve të gjyqësorit, por edhe kur miraton emërimin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të Kryetarit të saj si edhe kur zgjedh drejtpërdrejt tre anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në kundërshtim me pretendimet e kërkuesit, Gjykata Kushtetuese nuk gjen elementë të papajtueshëm me Kushtetutën në përmbajtjen e nenit 1 të ligjit objekt shqyrtimi, i cili ka bërë shtesa në pikën 2 të nenit 4 të ligjit të mëparshëm dhe ka përcaktuar **se anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë që zgjidhen nga Kuvendi nuk duhet të jenë gjyqtarë**. Një përcaktim i tillë është në pajtim, nga njëra anë, me parimin e balancimit të pushteteve që kërkon kontrollin dhe bashkëveprimin midis tyre ashtu edhe me formulën e nenit 147 të Kushtetutës, nga ana tjetër, sipas të cilit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë do të përfaqësohet jo vetëm gjyqësori me dhjetë anëtarë, por edhe pushteti legjislativ me tre anëtarë. Këta të fundit çojnë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë frymën e organit ligjvënës dhe, si të tillë, nuk duhet të zëvendësohen me gjyqtarë”.*

Sipas interpretimit të mësipërm z. Sokol Çomo dhe znj. Albana Shtylla, të cilat janë zgjedhur anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nga Parlamenti me propozim të Partisë Socialiste, kanë përcjellë në këtë institucion frymën politike të Kuvendit dhe të Partisë Socialiste. Pra kanë ushtruar një funksion politik.

i. Shkeljet dhe mashtrimet në zgjedhjen e Komisionierit Publik Dariel Sina

Zgjedhja e Komisionierit Publik Dariel Sina është e paligjshme pasi është shkelur kriteri i përvojës së punë jo më pak se 10 vjet sipas parashikimeve të nenit 6(3) e Ligjit nr. 84/2016. Konkretisht nuk ka pasur 10 vjet përvojë në funksionet e parashikuara nga neni 6(1)(b) e Ligjit nr. 84/2016 si gjyqtare, prokurore, lektorë e së drejtës, avokate, notere, juriste e nivelit të lartë në administratën publike, ose profesione të tjera që lidhen me sistemin e drejtësisë. Konkretisht sipas CV-së dorëzuar tek Avokati i Popullit Dariel Sina ka këto përvoja pune:

- Janar 2001 - gusht 2003 asistent avokat në zyrë avokatie Greqi,
- Nëntor 2003 - gusht 2005 asistent avokat në zyrë avokatie Greqi,
- Dhjetor 2005 – gusht 2009 asistent avokat në zyrë avokatie Greqi.

Puna e kryera nga ky kandidat në Greqi deri në gusht 2009, asistent avokat, nuk hyn në kategoritë e atyre që kërkon neni 6(3) e Ligjit nr. 84/2016 si përvojë 10 vjeçare, dmth gjatë kësaj periudhe ka 0 vite përvojë pune. Prej muajit tetor 2009 deri në muajin dhjetor 2016⁵⁴ ka punuar në Shqipëri si profesor i të drejtës. ***Pra ky kandidat ka vjetësi punë 7 vjet e 3 muaj përvojë pune për efekt kandidimi si Komisioner Publik.***

Në dosjen e dorëzuar për aplikim ndodhen tre dokumenta të lëshuar nga persona privatë në Greqi, të cilat në mënyrë të njëanshme deklarojnë se janë avokatë, me të cilat pretendojnë të vërtetojnë faktin se Dariel Sina ka punuar si asistent avokat ose praktikant për periudhën 2001 deri në vitin 2009. Asnjë nga këta Avokatë, as privatisht, nuk deklarohet që Dariel Sina ka qenë i punësuar dhe i siguruar sipas Ligjit në Greqi. Pra aplikanti gjatë 9 viteve mund të ketë qëndruar në këto zyra, mund të ketë hapur dhe mbyllur derën ose të ketë bërë ndonjë shërbim tjetër, por nuk ka asnjë dokument që të provojë faktin se ai është paguar dhe ka qenë i siguruar të paktën për punën si asistent avokat.

Po ashtu këto tre deklarata nuk kanë asnjë vlerë juridike para institucioneve të shtetit shqiptar pasi nuk janë paraqitur në formën e kërkuar sipas Ligjit.

Këto dokumenta nuk kanë vulë apostile të Greqisë, vendit ku janë lëshuar, të përkthyer në shqip dhe noterizuar sikurse e kërkon Ligji Shqiptar. Në kushtet kur një akt shkresor është mbajtur dhe lëshuar në territorin e një shteti tjetër si dhe në gjuhë të huaj, duhet të respektohen elementët formalë për vlefshmërinë e tij në Shqipëri sipas parashikimeve të Konventës e Hagës si dhe parashikimet e nenit 266 të Kodit të Procedurës Civile, i cili kërkon se “*Kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhë shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent*”. Madje sipas Konventës së Hagës datë 5 Tetor 1961 këto tre deklarata nuk mund të pajisen me vulë apostile të Greqisë pasi janë dokumenta private, që shprehin thjesht vullnetin ose dëshirat e individëve. Presidenti, Avokati i Popullit, ONM dhe Kuvendi nuk ka hetuar mbi vlefshmërinë ligjore dhe provueshmërinë e tyre, por i kanë marrë të mirëqena ato.

Këtë qëndrim ka mbajtur vetë **KP Dariel Sina në disa ankime të vendime të KPK dhe qëndrime para KPA**, në rastet ku Gjyqtarët dhe Prokurorët në procesin e rivlerësimit kanë paraqitur dokumenta të lëshuara nga Institucione Zyrtare, dhe jo më pastaj individë, jashtë teritorit të Republikës së Shqipërisë ***duke u shprehur se nuk kanë asnjë vlerë provuese për faktet e pretenduara nga subjektet pasi nuk janë paraqitur në mënyrën e kërkuar nga Ligji Shqiptar.***⁵⁵ ***Duke qenë se këto dokumenta nuk kanë asnjë vlerë, sikurse vetë ai mendon dhe është shprehur në ankime dhe qëndrime para KPA, ky aplikant nuk plotëson kriterin ligjor të vjetësisë në punë prej 10 vjetësh, ndaj dhe zgjedhja e tij është në kundërshtim të hapur me ligjin.***

Nëse marrim të mirëqenë deklarinimin në CV-në, sipas së cilës ka punuar për 9 vjet dhe është paguar nga avokatët pa shlyer detyrimet fiskale ndaj shtetit në Greqi, në

⁵⁴ Në datën 09.01.2017 ka paraqitur kërkesë dhe dokumentet të Avokati i Popullit për anëtar i institucioneve të rivlerësimit.

⁵⁵ Ankim i KP Dariel Sina kundër vendimit nr. 58 datë 01.08.2018 të KPK të subjektit të rivlerësimit Besnik Muçi, faqe 10; Ankimi kundër vendimit nr. 42, datë 18.07.2018.

këtë mënyrë Dariel Sina në bashkëpunim me avokatët ka shkelur legjislacionin tatimor, duke kryer evazion fiskal dhe kështu jo vetëm ka vënë në dyshim integritetin e tij etik dhe moral por njëkohësisht ka kryer dhe veprën penale të “Mospagimit të taksave dhe tatimeve”, kryer në Greqi, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 181 dhe 25 të Kodit të Penal. Edhe për këtë fakt ekspertët e ONM-së nuk ka kryer asnjë verifikim, edhe pse një pjesë e këtyre verifikimeve mund të kryheshin lehtësisht nga zyra online, nëse subjektet tatimore që aplikati pretendon e kanë regjistruar si punëmarrës, kur është regjistruar, nëse i ka paguar detyrimet, etj. Greqia është vend i Bashkimit Evropian dhe ONM-ja, si institucion edhe i Bashkimit Evropian, e kishte fare të lehtë ta kryente këtë verifikim. Minimumi që mund të verifikohet lehtësisht ishte nëse Dariel Sina ka qenë i pajisur me numër pune dhe numër sigurimesh shoqërore në Greqi. **Nëso jo rezulton se aplikanti ka shfrytëzuar tre shtetas grekë për të mashtruar shtetin Shqiptar dhe ONM-ja, Avokati i Popullit dhe Kuvendi e ka ligjëruar këtë mashtrim.**

Së fundi fakti që kandidati Dariel Sina jo vetëm nuk ka plotësuar vjetërsinë për edhe ka paraqitur të dhëna të rremë lidhur me faktin se punuar si asistent avokat në Greqi rezulton i qartë edhe nga kushtet që kërkon ligji 3026 i vitit 1954 për “Për Kodin e Avokatëve” në Greqi. Konkretisht sipas nenit 6 pika “a” të këtij ligji për të ushtruar profesionin e avokaktit në Greqi kërkohet si kriter shtetësia Greke ose e një vendi të Bashkimit Evropian. I njëjti kusht parashikohet edhe në nenin 11/1 të Ligjit lidhur me kushtet për të qenë asistent avokat. Në formularin e personalitetit Dariel Sina nuk ka treguar faktin që ka shtetësinë Greke apo të një vendi të Bashkimit Evropian. Në këto kushte rezulton i pavërtetë fakti që Dariel Sina ka punuar si asistent avokat në Greqi në periudhën 2001 deri në 2009. **Pra ai ose ka paraqitur një fakt të pavërtetë lidhur me shtetësinë që ka ose lidhur me faktin që pa punuar në Greqi si asistent Avokat.**

21. Konkluzione

- a. **Si konkluzion**, rezulton se Institucionet e shtetit Shqiptar Avokati i Popullit dhe ONM-ja në kundërshtim të qartë me parashikimet e nenit C(5) të Aneksit të Kushtetutës dhe me parashikimet e neneve 6, 7 dhe 8 të Ligjit nr. 84/2016 kanë dërguar në Kuvend si kandidatë që plotësojnë kushtet formale për anëtar të KPA-së aplikantët Ardian Hajdari, Natasha Mulaj dhe Rezarta Schuetz si dhe aplikantin Dariel Sina për Komisioner Publik, për të cilët dokumentacioni i depozituar prej tyre tregonte se përbëhej nga të dhëna të pavërteta e mashtruese që tregojnë se nuk i plotësonin kriteret ligjore.
- b. Kuvendi në kundërshtim të qartë me parashikimet Kushtetuese dhe Ligjore ka kaluar aplikanten Rezarta Schuetz nga lista e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret e lista që plotësojnë kriteret si dhe ka votuar aplikantët Ardian Hajdari dhe Natasha Mulaj për anëtarë të KPA-së dhe aplikantin Dariel Sina për Komisioner Publik në shkelje flagrante të procedurës së parashikuar në ligj.

22. Qëndrimet e ONM-së dhe KPA-së lidhur me zgjedhjen në shkelje të ligjit të antarëvetë KPA dhe KP.

- a. Kërkesave të mia për fillimin e procedimit disiplinor dhe shkarkimin e antarave të institucioneve të rivlerësimit **Ardian Hajdari, Rezarta Schuetz, Natasha Mulaj, Albana Shtylla, Sokol Çomo dhe Dariel Sina, pasi** nuk kanë plotësuar kriteret kushtetuese dhe ligjore në momentin e zgjedhjes, ONM dhe KPA nuk u janë përgjigjur.
- b. Por fakti që anari i KPA Ardian Hajdari është zgjedhur në shkeje të kriterëve kushtetuese dhe ligjore **provohet dhe nga përgjigjet që ONM-ja dhe KPA-së** i ka kthyer znj. Antoneta Sevdari ish-Anëtare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, lidhur me kërkesën e saj për fillimin e procesit disiplinor për shkarkimin e anëtarëve të KPA-së **Ardian Hajdari dhe Luan Daci** për shkak se nuk kanë plotësuar kriteret kushtetuese dhe ligjore në momentin e zgjedhjes. Konkretisht KPA-ja me shkresën e saj nr. 672/11 datë 04.12.2019 me lëndë kthim përgjigje Znj. Antoneta Sevdari nuk ka mohuar ekzistencën e kushteve të pazgjedhshmërisë për anëtarët e KPA-së por i bën me dije që nuk ka asnjë procedim disiplinor të regjistruar apo të filluar në KPA pasi pretendimet i përkasin periudhës para emërimit dhe fillimit të funksionit dhe se nuk aplikohen rregullat e parashikuara nga nenet 16 dhe 17 të Ligjit nr. 84/2016.
- c. Të njëjtën përgjigje i ka kthyer dhe ONM-ja ZNJ. Antoneta Sevdari, subjekt i procesit të rivlerësimit, **duke mos mohuar faktin që anëtarët e KPA-së kanë qenë në kushtet e pazgjedhshmërisë**, por kërkimet e Saj konsiderohen jashtë kushteve të zbatimit të neneve 16 dhe 17 të Ligjit nr. 84/2016. Në këtë mënyrë të dy këto institucione pranojnë faktin që të paktën z. Ardian Hajdari dhe z. Luan Daci kanë qenë në kushtet e pazgjedhshmërisë si anëtar i KPA-së, por duke qenë se këto fakte i përkasin periudhës para emërimit të tyre nuk mund të zbatohen parashikimet e Ligjit nr. 84/2016 për proces disiplinor. Pra, KPA dhe ONM me ndërgjegje pranojnë që KPA-ja, si Gjykatë, është dhe vazhdon të veprojë në kushte paligjshmërie pasi të paktën dy anëtarë të saj, z. Ardian Hajdari dhe z. Luan Daci, janë zgjedhur në kundërshtim me Kushtetutën dhe me Ligjin.

23. Në lidhje me kërkimin për detyrimin e organit publik Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të procedojë me konstatimin e pavlefshmërisë dhe anulimin e vendimit të Kuvendit të Shqipërisë Nr. 82/2017 “Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në Institucionet e Rivlerësimit sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në përgjigje të kërkesës së drejtuar atij nga paditësi Besnik Muçi, të datës 30.09.2020 për të cilën Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka heshtur , theksoj se në nenin 110 të K.Pr.A përcaktohet se : *“Pasojat dhe konstatimi i pavlefshmërisë absolute 1. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston. 2. Pavlefshmëria absolute e aktit mund të konstatohet në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, të çdo të interesuari, nga organi publik që e ka nxjerrë atë, organi epror i tij apo organi që është kompetent të shqyrtojë mjetet ligjore administrative, si dhe nga gjykata kompetente për çështjet administrative, sipas ligjit”*, ndërsa në nenin 114 të këtij Kodi përcaktohet se: *“ 1. Me përjashtim të*

rasteve të parashikuara në nenin 108, të këtij Kodi, një akt administrativ i paligjshëm mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin rivendosjen e ligjshmërisë.“

Nga ana tjetër, Neni 107 i Kodit të Pr.Administrative parashikon rastet se kur akti administrativ është i ligjshëm. Konkretisht *“Akti administrativ është i ligjshëm nëse është nxjerrë nga organi publik kompetent, në përputhje me parimet dhe kërkesat ligjore të parashikuara në këtë Kod, si dhe legjislacionin në fuqi”*.

- 24.** Akti administrativ i Kuvendit për emërimin e anëtarëve institucioneve të rivlerësimit nr. 82/2017 nuk është i ligjshëm pasi është marrë në shkelje flagrante të kërkesave të Kushtetutës dhe Ligjit Nr. 84/2016.

Referuar pretendimeve të parashtruara në padi, vetë Kuvendi si, organi shtetëror që ka nxjerrë aktin mund ta konstatojë pavlefshmërinë e tij dhe mund ta anulojë atë, pasi vendimi nr. 82/2017 është një akt jo vetëm absolutisht i pavlefshëm, por edhe i nxjerrë në kundërshtim me ligjin.

- 25.** Ky vendim është i paligjshëm për pjesën që i takon emërimit të pesë anëtarëve të KPA-së dhe një KP sikurse kam analizuar më sipër dhe pala e paditur Kuvendi i Republikës së Shqipërisë duhet të kishte marrë në shqyrtim kërkesën time të datës 30. 09.2020 dhe duhet të procedonte konstatimin e pavlefshmërisë së tij sipas nenit 110 të K.Pr.Administrative, apo me anulimin e tij në zbatim të nenit 114 të K.Pr.A, me qëllimin e vetëm atë të rivendosjes së ligjshmërisë.

- 26.** Me paraqitjen e kërkesës time për anulimin e vendimit nr. 82/2017, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ishte i detyruar që ta shqyrtonte atë brenda 60 ditëve, duke qenë se ligji nuk parashikon një afat konkret për nxjerrjen e një vendimi në këtë rast, duke qenë se nenin 91 i K.Pr.Administrative përcakton se: *“ Afati për përfundimin e procedurës administrative 1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe brenda afatit të përcaktuar nga ligji i posaçëm. 27 2. Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë”*.

- 27.** Duke mos iu përgjigjur kërkesës time, brenda afatit të përcaktuar në ligj, pra brenda afatit ligjor 60 ditor, mua si subjekt që kam kërkuar inicimin e një procedure administrative për nxjerrjen e një akti administrativ, në zbatim të nenit 17.1.ç të ligjit nr. 49/2012 më lind e drejta që t'i drejtohem gjykatës me padi për të detyruar organin publik Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, që të kryejë veprimin administrativ, për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë.

- 28.** E drejta e padisë për këtë kërkim në zbatim të nenit 18.1.d të Ligjit Nr. 49/2012 më lind brenda 45 ditëve nga data e mbarimit të afatit ligjor për nxjerrjen e aktit administrativ, në rastet e mosveprimit të organit administrativ, kur akti administrativ që është kërkuar të nxirret ankimohet drejtpërdrejt në gjykatë.

29. Kërkimet.

Nga sa më sipër, në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 179/b, B(1), B(2), B(3) gërma “a” e Aneksit, neni C pikat 5-12 e Aneksit; ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe p rokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 6, 7, 8, 9, 10, 11; Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë nenet Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë nenet 2(1), 3(6) dhe (7) pika “b”,

107, 108. a.i dhe ii , 108.b, 109/ d, 110, 114, 117, Ligji Nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” , i ndryshuar nenet 7/a dhe b, 10/1, 15/a, 17/1/c dhe ç, 18/1.d dhe 18.8,

K Ë R K O J

1. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit Nr. 82/2017 të Kuvendit “Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në Institucionet e Rivlerësimit sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit të Kuvendit Nr. 14 datë 06.03.2017 “Për kthimin e dosjeve të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit tek Avokati i Popullit për riplotësim të dokumentave dhe rihapjen e thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit nga aplikantë të rinj për pozicionet e të gjithë anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit” .

3. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit Nr. 18 datë 16.03.2017 “Për kthimin e dosjeve të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit tek Avokati i Popullit për riplotësim të dokumentacionit”

4. Detyrimin e organit publik Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të procedojë me konstatimin e pavlefshmërisë dhe anulimin e vendimit të Kuvendit të Shqipërisë Nr. 82/2017 “Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në Institucionet e Rivlerësimit sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në përgjigje të kërkesës së drejtuar atij nga paditësi Besnik Muçi, më datë 30.09.2020 për të cilën Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka heshtur.

Shënim: Bashkëngjitur kërkesë-padisë provat e mëposhtëme:

- Kopje Vendimi i Kuvendit Nr. 82 datë 17.06.2017, fletë 2 (dy).
- Kopje Vendimi i Kuvendit Nr. 14 datë 06.03.2017, fletë 2 (dy).
- Kopje Vendimi i Kuvendit Nr. 18 datë 16.03.2017 fletë 2 (dy).
- Kopje të Letërnjoftimit te paditësit e njëzuar me origjinalin fletë 1(një).
- Kopje Vendimi nr. 32 datë 21.11.2019 i KPA, njëzuar me origjinalin 37 fletë (tridhjetë e shtatë).
- Kopje kërkesë drejtuar Kuvendit të Republikës për anulimin e Vedimit nr. 82 të vitit 2017, njëzuar me origjinalin fletë 26 (njëzet e gjashtë)
- Kopje të Lajmërim Marrjes Postare nr. 192, njëzuar me origjinalin, fletë 1(një)
- Shkresë e Avokatit të Popullit dërguar paditësit nr. 8/1 datë 03/02/2020, kopje e njëzuar me origjinalin, fletë 1 (një)
- Thirrja e Avokatit të Popullit për paraqitjen e interesit për institucionet e rivlerësimit nr. Extra datë 26/01/2017, kopje e njëzuar me origjinalin, fletë 2 (dy)
- Protokoll i vlerësimit të kandidatëve nr. 20/1 datë 13/02/2017, kopje e njëzuar me origjinalin, fletë 3 (tre)
- Shkresa e Avokatit të Popullit drejtuar ONM nr. 32 datë 17/02/2017, kopje e njëzuar me origjinalin, fletë 2 (dy)

- Shkresa e Avokatit të Popullit drejtuar ONM nr. 37 datë 21/02/2017, kopje e njësuar me origjinalin, fletë 1 (një)
- Shkresë nr. 57 datë 03/03/2017 e Avokatit të Popullit drejtuar Kuvendit për përcjelljen e listave së bashku me listën e kandidatëve që përmbushin kriteret, kopje e njësuar me origjinalin, fletë 4 (katër)
- Shkresat e Kuvendit nr. 811/5 datë 07/03/2017 dhe 811/6 datë 10/03/2017 drejtuar Avokatit të Popullit, për kthimin e dosjeve të aplikantëve, kopje e njësuar me origjinalin, fletë 2 (dy)
- Shkresa e Avokatit të Popullit nr. 58/2 datë 15/03/2017 dërguar Kuvendit fletë 2
- Shkresa e Kuvendit nr. 938 datë 17/03/2017, njësuar me origjinalin, fletë 1 (një)
- Shkresa e Avokatit të Popullit nr. 67 datë 17/03/2017 dërguar ONM, kopje e njësuar me origjinalin, fletë 2 (dy)
- Thirrja e Avokatit të Popullit për plotësom dokumentacioni të kandidatëve për institucionet e rivlerësimit nr. 69 dt. 17/03/2017, njësuar me origjinalin fletë 2 (dy)
- Protokoll i vlerësimit të kandidatëve nr. 20/3 datë 28/03/2017, kopje e njësuar me origjinalin, fletë 2 (dy)
- Shkresë e Avokatit të Popullit nr. 85 datë 30/03/2017 dërguar ONM, kopje e njësuar me origjinalin, fletë 2 (dy)
- Shkresë e Avokatit të Popullit nr. 104 datë 17/04/2017 drejtuar Kuvendit për përcjelljen e listave së bashku me listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret, kopje e njësuar me origjinalin, fletë 6 (gjashtë)
- Dokumenta lidhur me antarin e KPA Ardian Hajdari, CV, kopje e njësuar me origjinalin, fletë 2 (dy)
- Shkresa nr. 590/1 datë 06/02/2020 e Këshillit të Lartë Gjyqësor drejtuar kërkuesit, kopje e njësuar me origjinalin, fletë 1 (një)
- Procesverbal i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. 22/4 datë 03/06/2016, kopje e njësuar me origjinalin, fletë 3 (tre)
- Procesverbal i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. 1195/1 datë 03/04/2015, kopje e njësuar me origjinalin, fletë 3 (tre)
- Vërtetimi datë 28/05/2013 i Gjykatës Tropojë, njësuar me origjinalin, fletë 1 (një)
- Dokumenta lidhur me antarin e KPA Natasha Mulaj kërkesë, deklarami i të dhënave për arsim dhe punësim, kopje e njësuar me origjinalin, fletë 6 (gjashtë)
- Dokumenta lidhur me antarin e KPA Rezarta Schuetz, shënimet e Avokatit të Popullit, CV, dokumet i OSCE anglisht, njësuar me origjinalin, fletë 9 (nëntë)
- Shkresa nr. 672/1 datë 04.12.2019 e Koligjit të Posaçëm të Apelit drejtuar Znj. Antoneta Sevdari, kopje e njësuar me origjinalin, fletë 1 (një).

P A D I T Ë S I

Besnik MUÇI

Tiranë, më 11.12.2020